


Arbnesha Mexhuani

# INTEGRIMI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE TË KOMUNIKIMIT NË MËSIMDHËNIE DHE NXËNIE



Prishtinë, 2014



Arbnesha Mexhuani

**INTEGRIMI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE  
TË KOMUNIKIMIT NË MËSIMDHËNIE  
DHE NXËNIE**

Prishtinë, 2014

**Botues:**

Instituti Pedagogjik i Kosovës

**Për botuesin:**

M. Sc. Ismet Potera

**Autor:**

Arbnesha Mexhuani

**Recensent:**

Prof. asoc. dr. Naser Zabeli

**Ekipi hulumtues:**

Arbnesha Mexhuani

Skender Mekolli

Zehrije Plakolli

**Përpunimi i të dhënave dhe  
përgatitja teknike:**

Skender Mekolli

**Lektor:**

Arif Demolli

---

## Përmbajtja

Përmbledhje .....	6
Hyrje.....	7
I. METODOLOGJIA .....	16
1.2. Dizajni i hulumtimit .....	17
1.3. Popullata dhe mostra .....	17
1.4. Instrumentet .....	18
1.5. Procedura e mbledhjes së të dhënave .....	18
1.6. Procedura e analizës së të dhënave .....	20
1.7. Pjesëmarrësit në hulumtim .....	20
II. REZULTATET ME MËSIMDHËNËS.....	22
2.1. Pajisja e shkollave me kompjuterë .....	24
2.3. Njohuritë e mësimdhënësve për përdorimin e kompjuterit ...	26
2.4. Vijimi i mësimdhënësve në trajnime për TIK .....	27
2.5. Organizatat që kanë ofruar trajnime për TIK-un .....	28
2.6. Programet kompjuterike që i zbatojnë mësimdhënësit .....	29
2.7. Integrimi i teknologjisë informative të komunikimit.....	31
në mësimdhënie .....	31
2.8. Metodatat mësimore përmes TIK-ut që zbatojnë .....	32
mësimdhënësit gjatë procesit mësimor .....	32
2.9. A mësojnë nxënësit përmes kompjuterit në.....	34
klasë dhe në shtëpi me udhëzime të mësimdhënësve ? .....	34
2.10. Disa arsye të mësimdhënësve që nuk e zbatojnë TIK- .....	35
un për mësimdhënie dhe nxënie .....	35
2.11. Përdorimi i TIK- ut nga fëmijët me nevoja të veçanta .....	37
2.12. Sa ju ofrojnë mësimdhënësit material shtesë nga.....	39

---

interneti.....	39
2.13. Përdorimi i internetit nga mësimdhënësit.....	40
Tabela 5.....	40
2.14. Sa i udhëzojnë mësimdhënësit nxënësit për ..... hulumtime në internet për nevoja mësimore .....	42
2.15. Materialet ndihmëse nga interneti .....	43
2.16. Sa janë të informuar mësimdhënësit se për çfarë .....	45
arsye nxënësit e përdorin internetin.....	45
2.17. Rëndësia e internetit për mësim.....	47
<b>III. REZULTATET ME NXËNËS</b> .....	<b>49</b>
3.1. Klasat e përfshira në hulumtim.....	49
3.2. Pajisja e shkollave me kompjuterë .....	50
3.3. Kurset për përdorimin e kompjuterit .....	50
3.4. Njohuritë e nxënësve për ta përdorur kompjuterin .....	51
3.5. Koha që shfrytëzojnë nxënësit pranë kompjuterit .....	52
3.6. Për çka e përdorin nxënësit kompjuterin .....	53
3.7. Programet kompjuterike që përdoren nga nxënësit .....	55
3.8. Integrimi i TIK-ut gjatë procesit të mësimdhënies .....	57
3.9. Përdorimi i metodave mësimore përmes TIK-ut nga ..... mësimdhënësit .....	57
3.10. Përdorimi i mjeteve tjera audio-vizuale..... ( TV, DVD, projektor... ).....	59
3.11. Përdorimi i TIK-ut sipas udhëzimeve të mësimdhënësve ...	61
3.12. Sa i udhëzojnë mësimdhënësit që përmes integritit të ..... TIK-ut të kryejnë detyrat e shtëpisë .....	62
3.13. Mësimdhënësit lëndorë që integrojnë TIK- në mësim .....	63
3.14. Ndikimi i kompjuterit në arsimimin e nxënësve.....	65
3.15. Rëndësia e TIK-ut për mësim.....	66

---

3.16. Opinionet e nxënësve .....	69
3.17 Opinionet e mësimeve.....	70
Gjetjet kryesore nga hulumtimi.....	72
IV. PËRFUNDIM .....	74
V. REKOMANDIME .....	76
5.1. Rekomandime për mësimeve.....	76
5.2. Rekomandime për MASHT-in .....	79
5.3. Rekomandime për nxënës.....	80
5.4. Rekomandime për prindër .....	82
Literatura .....	83

---

## PËRMBLEDHJE

Hulumtimi *Integrimi i teknologjisë informative të komunikimit në mësimdhënie dhe nxënie* është një domosdoshmëri, sepse një ndër prioritetet kryesore të MASHT-it për TIK, të paraqitur në Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2011-2016, është edhe integrimi i teknologjisë mësimore në procesin e mësimdhënies dhe të nxënies. Ky hulumtim fokus kryesor ka studimin e gjendjes në disa shkolla të mesme të ulëta, për mënyrën e integritit të teknologjisë informative në procesin e mësimdhënies dhe të nxënies. Hulumtimi është kryer në katër shkolla të Prishtinës dhe katër shkolla të fshatrave të Prishtinës. Është kërkuar që të gjendet një mesatare e nxënësve dhe e mësimdhënësve, të cilët integrojnë TIK-un në klasat e nivelit të mesëm të ulët. Nxënësit dhe mësimdhënësit janë anketuar përmes pyetësorëve përkitazi me zbatimin e TIK-ut për mësimdhënie, si dhe mënyrat e përdorimit të tij. Përmes pyetësorëve janë anketuar nxënës të klasave të shtata dhe të nënta. Ndërkaq sa i përket mësimdhënësve, janë anketuar mësimdhënës klasor, mësimdhënës të klasave të gjashta, shtata, teta dhe të nënta. Pyetjet kanë qenë të hapura dhe të mbyllura. Për analizën e të dhënave teorike janë shfrytëzuar metodat e hulumtimit shkencor, si metoda krahasuese, përshkruese dhe statistikore. Ndërsa, analizat e të dhënave të grumbulluara përmes pyetësorëve janë paraqitur në formë kuantitative dhe kualitative. Gjatë këtij procesi komentet e nxënësve ishin kategorizuar në tema lidhur me integrimin e TIK-ut në mësimdhënie. Së fundi, punimi nxjerr në pah se integrimi i TIK-ut në procesin e mësimdhënies ende nuk është duke u realizuar në atë masë sa që nxënësit TIK-un ta përdorin për nevoja arsimore. Punimi përfundon me një diskutim të këtyre rezultateve dhe zbatueshmërinë që kanë këto rezultate drejt politikës së edukimit të tashëm dhe reformave në Kosovë.



---

## HYRJE

Integrimi i teknologjisë informative të komunikimit në mësimdhënie dhe nxënie nënkupton përdorimin e kompjuterëve dhe software-ve në mënyrë produktive, shfrytëzimin e internetit dhe përdorimin e rrjeteve kompjuterike për qëllime të mësimdhënies dhe të nxënies. Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, duke u mbështetur në prirjet globale të jetës dhe të arsimit të sotëm, si dhe në kompetencat evropiane për arsimin (një ndër të cilat është përdorimi dhe zhvillimi i aftësive të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit), ka vendosur si prioritet të sajin integrimin e TIK-ut në mësimdhënie/nxënie. Përdorimi i TIK-ut në të gjitha proceset jetësore është kthyer në një domosdoshmëri jetike në mbarë botën. Edhe në arsim, si në çdo fushë të jetës, TIK-u ka sjellë një kthesë rrënjësore në zhvillimin e kulturës së të nxënës, duke i bërë njohuritë më të qasshme për të gjithë nxënësit. Aplikimi i TIK-ut në mësimdhënie, ofron përfitime të mëdha për nxënësit dhe rrit aftësitë konceptuese dhe perceptuese të tyre gjatë orës së mësimi duke lehtësuar të nxënës. TIK-u sjell dinamizëm në mësimdhënie/nxënie dhe i vendos nxënësit në kontroll për të nxënës të tyre, duke lejuar progres zhvillimi të pavarur.

TIK-u, si aftësi funksionale e lexim-shkrimit digjital, nxit dhe zhvillon te nxënësit një sërë aftësish të tjera, të tilla si: aftësi matematikore, aftësi komunikuese, aftësi të të menduarit kritik dhe të zgjidhjes së problemeve, aftësi për të punuar në grup, aftësi për të përdorur shumëllojshmëri burimesh e instrumentesh etj. Mirëpo dukuri shqetësuese te ne është se TIK-u në masë të madhe po keqpërdoret nga nxënësit duke

---

qëndruar orë të tëra pranë kompjuterit dhe duke e përdorur për Fcb. dhe lojëra të ndryshme. Te këta fëmijë mungojnë udhëzimet konkrete në orientimin për përdorimin e drejtë të tij. Përveç familjes, që luan një rol të madh në kontrollimin e fëmijëve gjatë përdorimit të kompjuterit, rol shumë të rëndësishëm luajnë edhe mësime të cilët me udhëzimet e tyre, mund t'i stimulojnë nxënësit që TIK-un ta përdorin për nevoja mësimore.

Pajisja e shkollave me kompjuterë ndikon në masë të madhe në përdorimin e drejtë të tij. Mësime të cilët gjatë orëve mësimore me udhëzime të tyre dhe me këshilla konkrete kanë mundësi t'i orientojnë nxënësit në përdorimin e drejtë të kompjuterit. Por jo të gjitha shkollat e kanë një mundësi të këtillë. Një numër i konsiderueshëm i tyre kanë vetëm nga një apo dy kompjuterë, të cilët i përdor drejtori i shkollës. Megjithatë, pavarësisht kësaj, mësime të cilët mund të gjejnë mënyra të ndryshme për integrimin e teknologjisë si mjet pune për nevoja arsimore, qoftë me përdorimin e pajisjeve të tyre personale si laptop, i-pad, apo me shfrytëzimin e pajisjeve të kolegëve të tyre e në disa raste edhe kur vetë nxënësit sjellin në shkollë laptopat e tyre. Shpenzimi i kohës së nxënësve duke keqpërdorur kompjuterin për komunikim dhe lojëra të ndryshme mund të shndërrohet në përdorim efektiv të tij në qoftëse mësime të cilët integrojnë TIK-un në procesin e të nxënësve, duke i udhëzuar nxënësit që të hulumtojnë për nevojat e tyre mësimore të përshtatura në kurrikulën e tyre lëndore. Qasja e mësime të cilët duke përdorur metodën tradicionale të punës, mësuesi në qendër, dhe dhënia e informatave duke u bazuar vetëm në pjesën teorike të materialeve, është edhe një ndër faktorët që ndikon në pasivizimin e nxënësve dhe në mos stimulimin e tyre për punë, për këtë arsye është edhe i

---

nevojshëm ky hulumtim; të vlerësohet se sa dhe si mësimdhënësit i stimulojnë nxënësit e tyre që kompjuterin ta përdorin si mjet pune, për të siguruar cilësinë e rezultateve arsimore, meqenëse çdo shteg i të nxënësve ngrihet dhe duhet të burojë nga mësimdhënësit.

## **INTEGRIMI I TIK-UT NË MËSIMDHËNIE DHE MËSIMNXËNIE SIPAS LITERATURËS BASHKËKOHORE**

Një përmbledhje bashkëkohore e literaturës që ka të bëjë me studimenga praktika të suksesshme dhe politika arsimore ilustron progres të rëndësishëm në Evropë, nëpërfshirjen e TIK-ut në mësimdhënie. Gjatë studimit të literaturëskemi hasur seidentifikimi i kriterëve për praktikat e suksesshme të TIK- ut në fushën e arsimit është tepër i vështirë, për shkak se një praktikë që ka funksionuar mirë në një kontekst, mund të mos jetë aspak e tillë në një kontekst tjetër.

Pajisja e shkollave me TIK është zakonisht hapi i parë në agjendën e hartuesve të politikave, megjithatë investimi vetëm në pajisjen e shkollave me teknologji informative të komunikimit ishte një praktikë jo e mirë, ashtu siç raportuan disa nga vendet evropiane. Politikat duhet të sigurojnë një vizion afatgjatë, të shpjeguara në objektiva të detajuara në një shkallë të gjërë veprimi, të “zgjerimit të aksesit për të gjithë, rritje të cilësisë së arsimit, riformim i organizimit dhe i menaxhimit të proceseve të arsimit, aftësimi për të nxënësit afatgjatë, shtimi i kompetencave të TIK-ut të nxënësve, mësuesve dhe stafitadministrativ, ngritja e efektshmërisë në

---

administrimin e shkollës”. „Çështje kryesore sipas studimeve të shumta është përqëndrimi në shfrytëzimin e TIK nga mësuesit dhe nxënësit për qëllime arsimore, sesa shfrytëzimi praktik i kompjuterëve bashkë me mjetet dhe programet e tij”<sup>1</sup>. Lidhur me këtë çështje duhet të përcaktohet një program. „Mësuesve u nevojiten (80%) shprehi jo teknik e dhe (20%) shprehi teknike, ndërsa „nxënësit, së pari duhet të përpunojnë informacionin që marrin, dhe pastaj ta lidhin atë me përvojat që ata njohin nga jeta e tyre: pra lidhja e teknikës me jetën reale dhe me natyrën”<sup>2</sup>. Pavarësia, puna në grupe. „shprehitë baza të nevojshme (të lexuarit, të shkruarit, skicimi) dhe shprehi të tjera të nivelit të lartë të njohjes janë kushte paraprake për një përdorim të suksesshëm të TIK-ut”<sup>3</sup>.

Në librin CALL Environments (Egbert & Hanson-Smith, 1999) janë përshkruar disa metoda se si të zhvillohet mësimi me anë të mjeteve të ndryshme teknologjike për grupet e ndryshme të pjesëmarrësve (nxënësve). Një ndër metodat ishte edhe metoda e bashkëveprimit gjatë mësimimit përmes TIK-ut. Sipas tij, kjo metodë relizohet nxënës me nxënës, nxënësi me grupin dhe grupi me grupin. „Nxënësit mundën që gjithashtu të bashkëveprojnë me njerëz të ndryshëm, si me shokët e klasës, mësuesin, nxënësit e klasave të tjera, nxënës nga komunitete të ndryshme dhe njerëz nga e gjithë bota. Meqë nxënësit vendosen nëpër grupe, prej tyre kërkohet që të jenë aktivë në orë, për këtë kërkohet bashkëpunimi, por për të arritur këtë

---

<sup>1</sup>Brown, J. D. Computers in language testing: Present research and some future. 1997. f.37.

<sup>2</sup>Musai, Bardhyl, Godole Tidita, Abdurrahmani Jonila. Edukimi Mediatik. Tiranë. 2011

<sup>3</sup>[http://europa.eu.int/comm/education/pol/policy/\\_en.html#programe](http://europa.eu.int/comm/education/pol/policy/_en.html#programe) (pare për herë të fundit më: (25.02.2013 )

---

bashkëveprim që mësimi të bëhet sa mi i lehtë, kërkohet që mësuesi të sigurojë që bashkëveprimi të jetë efektiv”<sup>4</sup>. „Teknika të tjera janë kur mësuesit i zhvillojnë detyra, të cilat rrisin mundësinë e bashkëveprimit social sa më cilësor. Përmes kësaj teknike, mësuesi duhet të përpiqet që të gjithë nxënësit të jenë aktivë në orë. Ka nxënës të cilët nuk janë aktivë në orë, atëherë mësuesi/ja duhet t’ia caktojë secilit nga një rol specifik, në mënyrë që të gjithë nxënësit në grup të marrin pjesë edhe së bashku të arrijnë qëllimin e grupit. Kjo strukturë mundëson që nxënësit të kontaktojnë me njëri-tjetrin duke mësuar. Sa më shumë që të kenë nevojë për bashkëpunim, aq më shumë efektiv do të jetë bashkëpunimi. Këto principe janë bazat e teknikave si mësimi kooperativ (bashkëpunues)”<sup>5</sup>. Teknikë tjetër është prezantimi i punimeve në klasë. Nxënësit i prezantojnë punimet e tyre në klasë për t’i vlerësuar mësuesi/ja. Shtrohet pyetja: Cila është arsyeja që nxënësit e tjerë të dëgjojnë prezantimet e grupeve të tjera? „Mësuesi/ja duhet t’u paraqesë nxënësve arsye për të dëgjuar prezantimet, si, për shembull, të bëjnë vlerësimin e prezantimeve të shokëve, të marrin shënime, që do t’u duhen për ndonjë kuiz apo test, ose të kërkohet ndonjë përmbledhje e prezantimit që ata dëgjuan”<sup>6</sup>. Në këtë mënyrë mësuesi i inkurajon të gjithë nxënësit që të dëgjojnë dhe të japin përgjigjet e duhura.

---

<sup>4</sup>Joy Egbert and Elizabeth Hanson-Smith., CALL Environments: Research, Practice, and Critical Issues, page 55.

<sup>5</sup> Po aty f. 57.

<sup>6</sup>Sivakova, D. Ndikimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në përmirësimin e mësimit, Bitola, 2007. f. 86

---

## **Pajisja e shkollave me kompjuterë dhe funksionimi i tyre sipas modeleve të huaja**

Pajisja e shkollave me kompjuterë dhe mënyra e shfrytëzimit të tyre është një faktor që ndikon në bashkëveprimin dhe në bashkëpunimin e nxënësve, prandaj mësuesi duhet të ketë parasysh organizimin e klasave gjatë dizajnit të aktiviteteve që realizohen me ndihmën e teknologjisë mësimore. Pasiqë procesi i mësimdhënies „nuk është pranim dhe shpërndarje e diturive por edhe proces i shumë anshëm i cili realizohet me aktivitete si, vizatime, këngë, lojë, aktivitete sportive, si dhe përmes Tik-ut<sup>7</sup>.

Vendosja e kompjuterëve mund të bëhet në mënyra të ndryshme, duke i vendosur në kabinete të informatikës deri te klasat me një dhe shumë kompjuterë.

### ***Shkollat shtetërore në Shtetet e Bashkuara të Amerikës***

Shkollat në SHBA i pajisin zakonisht arsimtarët me nga një kompjuter, edhe pse një kompjuter mund të duket i pamjaftueshëm për disa aktivitete që bëhen me ndihmën e kompjuterit. Klasa me një kompjuter ka disa përparesi:

Mësimdhënësi/ja mund të shohë se çfarë janë duke bërë nxënësit në kompjuter.

Mësimdhënësi/ja ka më shumë kontroll mbi nxënësit dhe më shumë mundësi për të lehtësuar udhëzimet.

Teknologjia është çdo kohë në dispozicion.

Nxënësit mund të shohin njëri-tjetrin dhe të bashkëpunojnë pa pengesa.

Është më e lehtë për mësuesin/en të japë informatë kthyesë.

---

<sup>7</sup> August Vitak “Osnovni problemi vo rabotata na grupi, Beograd, 1964, f 57

---

Duke pasur vetëm një kompjuter në klasë, vëmendja zhvendoset nga teknologjia në mësim dhe në bashkëveprim.

Është më e lehtë të përdorësh vetëm një konfiguracion.

Në mjedise të këtilla nxënësit nuk bashkëpunojnë me shokë të tjerë me të largët, por klasat etilla janë shumë të përshtatshme për përforcimin e marëdhënieve me shokët në klasë (komunikimi sy nësy). Këto tri kontekste: laboratorit, klasa me shumë kompjuterë dhe klasa me një kompjuter – dhe shumë mjedise të tjera të pajisura më mjete të teknologjisë ndihmojnë dhe përkrahin aktivitete të ndryshme mësimore

### **Bashkëveprimi në një klasë me shumë kompjuterë**

Në klasat me shumë kompjuterë mund të bëhen më shumë aktivitete grupore. „Klasat me shumë kompjuterë kanë më shumë përparësi se sa një kabinet tradicional i kompjuterëve. Në këtë lloj të klasave, ku monitorët e kompjuterëve janë të futura në tavolina dhe tavolinat të organizuara në grupe nga tre ose katër, nxënësit mund të shohin më lirshëm njëri-tjetrin dhe mësuesin dhe të komunikojnë më lirshëm”<sup>8</sup>. Ndryshe nga kabinetet, nxënësit kanë hapësirë të punojnë pa kompjuterin dhe të përdorin atë vetëm kur u duhet ose nëse u duhet. Në këtë mjedis teknologjia shërben si mjet për të gjitha llojet e ushtrimeve (detyrave), që nga krijimi i faqeve të internetit deri në krijimin e portfoliove personale. Në këto mjedise mësuesit mund të japin detyra të cilat bëhen me ndihmën e kompjuterit, gjatë së cilave nxënësit punojnë me shokët e tyre në internet ose me shokët e klasës që i kanë afër.

---

<sup>8</sup>Joy Egbert and Elizabeth Hanson-Smith. CALL Environments: Research, Practice, and Critical Issues.1999 f. 67

---

## **Metoda e bashkëveprimit në kabinetin e TIK-ut**

Në një klasë tradicionale ku mësimi zhvillohet me ndihmën e teknologjisë, nxënësit rrinë në vendet e tyre, ose ulen para kompjuterit, që mund t'ua bllokojë shikimin atyre që janë prapa dhe ata nuk mund të shohin. Edhe pse thuhet se këto kabinate i takojnë së kaluarës, ata janë të dobishëm jo vetëm për aktivitetet individuale të nxënësve, si përdorimi i programeve të ndryshme, kërkimi në internet, shkrimi i letrave, dërgimi i letrave elektronike dhe plotësimi i aktiviteteve tjera, por gjithashtu edhe për të punuar në detyra individuale si pjesë e bashkëpunimit me ndonjë person tjetër online. Megjithatë mundësitë e kufizuara për të lëvizur dhe vështirësia për të ndarë programin e vështirëson bashkëpunimin sy më sy për më shumë nxënës, ose nxënëse që punojnë në grupe. Këto klasa janë më të mira për mësimin individual dhe për bashkëpunime që bëhen online (përmes internetit).

## **Pajisja e shkollave me teknologji mësimore ndihmëse për nxënësit me nevoja të veçanta**

Arsimi gjithëpërfshirës bazohet në ide të rëndomtë se çdo fëmijë dhe çdo familje janë të vlerësuar njësoj dhe meritojnë përvoja dhe mundësi të barabarta. Duke u bazuar në këtë, është e rëndësishme për të siguruar ndihmë për secilin fëmijë gjatë të mësuarit dhe pjesëmarrje të barabartë. E drejtë e çdo fëmije me nevoja të veçanta arsimore është që të edukohet me fëmijë të moshës së njëjtë dhe të kenë qasje në programin e përgjithshëm edukativ<sup>9</sup>. Ekziston teknologjia mësimore ndihmëse, që

---

<sup>9</sup><http://affnet.ucp.org/uploads/Inclusive%20Education.pdf> (parë për herë të fundit ( 17 shtator2014)



---

shumë qendra informative kombëtare në Evropë kanë bërë klasifikimin e pajisjeve që janë projektuar kryesisht për njerëzit me nevoja të veçanata. „Teknologjia ndihmëse hap botë të re për fëmijët në procesin e gjithëpërfshirjes”<sup>10</sup>

Pajisjet ndihmëse të teknologjisë u mundësojnë personave me aftësi të kufizuara realizimin e detyrave të përditshme jetësore, ndihmojnë në komunikim, arsim, punë apo në detyra rekreative, përkatësisht u ndihmojnë për të arritur pavarësi më të madhe në rritjen e kualitetit të jetës së tyre. Në teknologji mësimore ndihmëse përfshihen: ***pajisjet alternative hyrëse që janë:*** „tastiera alternative dhe të adaptuara, tastiera të zgjeruara, maus ergonomik dhe alternativ, sisteme për tregues (kursorë), pajisje që e kontrollojnë kursorin me kokë, pajisje që kontrollojnë kursorin me lëvizjen e syve apo të gojës, përkatësisht të gjuhës, klikime, ekran me të prekur, sistem për njohjen e të folurit, programe për konvertimin e të folurit në tekst, program për diktim, tastiera virtuale, programe për ndërrimin e kursorit, pajisje ergonomike kompjuterike etj. ***Pajisjet alternative dalëse*** u kushtohen përgjithësisht personave të verbër apo me dëmtime shikimi, që u ndihmon t’i përdorin dhe të ndërveprojnë me kompjuterin. Këtu përfshihet tastatura Brain. Teknologjia ndihmëse hap botë të re për fëmijët në procesin gjithëpërfshirës. Ajo u mundëson të kenë qasje te programi i shkollave të rregullta dhe të jenë të suksesshëm në mësim.”<sup>11</sup>

---

<sup>10</sup>Lawrence. Johnston, L. Carpenter, L. (2007), „*Assistive technology access for all students*“, Pearson, New Jersey, f. 85

<sup>11</sup> Po aty, f. 88,89, 90

---

## I. METODOLOGJIA

Në tekstin vijues do të shqyrtohen aspektet metodologjike të hulumtimit mbi mënyrën e integritit të TIK-ut në mësimdhënie dhe nxënie nga mësimdhënësit dhe nxënësit. Gjatë fazës së parë të punës, ne i kemi kushtuar vëmendje të posaçme përcaktimit të çështjeve kryesore mbi të cilat edhe kemi realizuar punën për të ardhmen. Një nga detyrat para, me të cilat jemi marrë është hulumtimi dhe analiza e mënyrave të mësimdhënies përmes integritit të TIK-ut. Kjo fazë e punës ka filluar me një pasqyrim mbi kriteret dhe studimet ekzistuese, mbi integritin e TIK-ut në mësim. Kjo është arritur duke studiuar literaturë dhe burime të tjera që lidhen me integritin e TIK-ut në mësimdhënie dhe nxënie, si dhe duke bërë analizën e politikave arsimore ndërkombëtare dhe vendore.

Hulumtimi është bërë në tetë shkolla. Katër shkolla kanë qenë të qytetit të Prishtinës dhe katër të fshatrave të komunës së Prishtinës. Janë përgatitur instrumentet e hulumtimit pyetësorët, ndërsa si teknikë është përdorur anketimi i mësimdhënësve dhe i nxënësve. Pyetësorët janë shpërndarë në shkolla dhe janë plotësuar nga mësimdhënësit dhe nxënësit. Pas grumbullimit të pyetësorëve, ka filluar futja e të dhënave të pyetësorëve në programin kompjuterik SPSS. Faza tjetër është raportimi, që bazuar në të dhënat nga hulumtimet dhe diskutimet e grupit punues, ne kemi nxjerrë një raport me rekomandimet për Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për mësimdhënësit dhe për nxënësit. Faza përfundimtare është faza e publikimit, në të cilën paraqiten rezultatet nga hulumtimi, që do të shërbejnë si rekomandime për të ardhmen për Ministrinë e Arsimit.

---

## **1.2. DIZAJNI I HULUMTIMIT**

Hulumtimi që është realizuar në këto shkolla është një hulumtim cilësor dhe sasior, që është një mënyrë e veçantë e mbledhjes, organizimit dhe analizës së të dhënave. Qëllimi i këtij hulumtimi ka qenë të grumbullojë informacione gjithëpërfshirëse, sistematike dhe në thellësi për secilin rast interesi–studimi. Hulumtimi është kryer në katër shkolla të mesme të ulëta të fshatrave dhe katër shkolla të qytetit. Nxënësit e shkollave të mesme të ulëta janë përfshirë në këtë studim për arsye se niveli i arsimit të mesëm të ulët është bazë e të nxënit dhe e ndryshimeve, d.m.th. këta nxënës janë më të prirur për t’iu ekspozuar ndryshimeve. Këto ndryshime padyshim po shkaktojnë efekte të ndryshme të nxënësit, duke filluar nga dëshira e madhe për të hulumtuar në rrjetë, qëndrimi i gjatë para kompjuterit, e deri të humbja e interesimit të tyre për mësim dhe largimi i vëmendjes nga shkolla. Arsye tjetër e zbatimit të hulumtimit me këto grupmosha është se edhe Korniza e Kurrikulës për arsimin fillor dhe të mesëm parasheh që mësimdhënia dhe nxënia të mbështetet edhe në integrimin e çështjeve ndërkurikulare: si teknologjia informative e komunikimit. Përmes këtij studimi synohet të identifikohen mënyrat e integrimittë teknologjisë informative në procesin e mësimdhënies dhe nxënies.

## **1.3. POPULLATA DHE MOSTRA**

Për të marrë informacione sa më gjithëpërfshirëse dhe për të pasur një pasqyrë sa më reale të gjendjes, në hulumtim janë përfshirë nxënësit dhe mësimdhënësit e nivelit të mesëm të ulët.

---

*Madhësia e mostrës me nxënës:* Mostra e nxënësve përbëhet prej 235 nxënësve: 187 nxënës kanë qenë nga klasa e nëntë dhe 48 nga klasa e shtatë.

*Madhësia e mostrës me mësimdhënës:* Mësimdhënës kanë qenë gjithsej 90: 20% të tyre kanë qenë klasorë, ndërsa të tjerët lëndorë.

#### **1.4. INSTRUMENTET**

Hulumtimi është realizuar përmes pyetësorëve, që është një metodë e përshtatshme për grumbullimin e të dhënave dhe për të nxjerrë rezultate të përgjithëshme. Përmes pyetësorëve ne kemi bërë një hulumtim sasior dhe cilësor të mbledhjes së të dhënave. Pyetësorët janë hartuar për mësimdhënësit dhe për nxënësit. Pyetjet për mësimdhënës kanë qenë të ndryshme nga pyetjet që kemi hartuar për nxënësit. Pyetjet kanë qenë të hapura dhe të mbyllura. Metoda përmes pyetësorëve ishte menduar si metoda më e mirë për të nxjerrë të dhënat e nevojshme për këtë studim.

#### **1.5. PROCEDURA E MBLEDHJES SË TË DHËNAVE**

Për realizimin e këtij hulumtimi së pari është realizuar pilot studimi me dhjetë nxënës dhe katër mësimdhënës. Shkolla për pilotimin e pyetësorit është zgjedhur në Prishtinë. Pyetësorët e përgatitur për shkollën pilot e këtij studimi ishin të ngjashëm me ata të pjesëmarrësve të këtij studimi. Synimi i këtij studimi pilot ishte që të sigurojë se struktura e pyetësorit nuk ka asnjë dykuptimësi. Nga pjesëmarrësit u njoftuam se nuk ka asnjë paqartësi dhe se orari i anketimit ishte i përshtatshëm.

---

Anketimet pilot të përfunduara nuk janë përfshirë në analizën e të dhënave dhe të interpretimit të tyre.

Anketimi përmes pyetësorëve ishte paraparë për të mbledhur të dhëna për këtë studim. Pyetësorët ishin hartuar me pyetje të hapura dhe të mbyllura. Përmes pyetjeve të hapura ne kemi bërë një analizë cilësore të të dhënave, ndërsa përmes pyetjeve të mbyllura ne kemi bërë analizë statistikore të të dhënave përmes programit SPSS. Studimi lidhet me hulumtimin e mënyrave të integritit të TIK-ut në procesin e mësimdhënies dhe nxënies. Para anketimit kemi hulumtuar literaturë shkencore që ka të bëjë me mënyrat e integritit të TIK-ut në procesin e mësimdhënies dhe nxënies dhe pastaj kemi parashtruar pyetje përmes të së cilave kemi menduar se mund të marrim të dhëna të dobishme që kanë të bëjnë me përfshirjen e TIK-ut në procesin e mësimdhënies dhe të nxënies. Para fillimit të grumbullimit të të dhënave kemi bërë përzgjedhjen e shkollave. Pas përzgjedhjes së shkollave, në to u organizua një seancë e para anketimit me mësimdhënës dhe nxënës. Kjo ishte për t'u dhënë detaje dhe për t'i informuar pjesëmarrësit me qëllimin e këtij studimi dhe çka pritet nga ata. Po ashtu ky takim është bërë edhe për të ndërtuar raporte në mes të hulumtuesve dhe pjesëmarrësve. Pjesëmarrësve për observimin e të dhënave iu dhanë udhëzime të shumta për mënyrën e plotësimit të pyetësorëve dhe qëllimin e tij. Gjatë plotësimit të pyetësorëve, që ka zgjatur 20-30 minuta, ne kemi vëzhguar në klasë deri në përfundimin e anketimit. Mësimdhënësit u janë përgjigjur pyetjeve ndaras nga nxënësit.

---

## **1.6. PROCEDURA E ANALIZËS SË TË DHËNAVE**

Pas leximit të shumëfishtë dhe rileximit, nocionet dhe temat që janë përmendur nga pjesëmarrësit janë identifikuar dhe janë grupuar së bashku. Pyetësorët janë analizuar duke përdorur një qasje tematike të analizave. Vëmendje parësore e analizave iu përkushtua përmbajtjes dhe temave që pjesëmarrësit përmendën, si një mënyrë për të nxjerrë rezultatet e këtij hulumtimi. Kjo mënyrë e analizave është kryer për të siguruar besueshmërinë në analizat e të dhënave. Për të arritur deri te raportimi i gjetjeve kemi përdorur metodën statistikore dhe metodën përshkruese. Për të analizuar si duhet këtë problem kemi përdorur metodën statistikore. Metoda statistikore është përdorur për gjetjen e rezultateve që kemi paraqitur përmes grafikëve dhe tabelave të ndryshme. Ndërsa për të identifikuar tema të ndryshme dhe për të paraqitur gjetjet nga ky hulumtim, kemi përdorur metodën përshkruese. Pra përmes kësaj metode kemi bërë edhe përshkrimin e të dhënave, si dhe kemi paraqitur rekomandimet për autoritetet relevante përkitazi me veprimtaritë që duhet ndërmarrë për përfshirjen e teknologjisë informative në procesin e mësimdhënies dhe të nxënies, si dhe në përmirësimin e cilësisë në arsim. Përpunimi i këtyre të dhënave është bërë me SPSS.

## **1.7. PJESËMARRËSIT NË HULUMTIM**

Për studim kam përdorur mostra të qëllimshme të shkollave të arsimit të obliguar. Më konkretisht, nxënësit ishin të moshës 13-15-vjeçare, ndërsa mësimdhënësit ishin mësimdhënës lëndorë dhe klasorë. Numri i nxënësve që kanë qenë pjesëmarrës në këtë studim kanë qenë tridhjetë nga çdo shkollë, si në qytet ashtu edhe në fshat. Në hulumtim janë përfshirë 187

---

nxënës të klasave të nënta dhe 48 të klasave të shtata. Prej tyre 118 femra apo 50.9% dhe 114 meshkuj apo 49.1 %. Ndërsa, sa i përket mësimdhënësve, ata kanë qenë të mësimit klasorë dhe mësimdhënës lëndorë. Mësimdhënës klasorë kanë qenë 19 %, ndërsa pjesëmarrës kanë qenë edhe mësimdhënësit lëndorë. Përqindja e tyre në këtë studim ishte: 13.5% mësimdhënës të gjuhës angleze, të historisë me 10.1 %, të teknologjisë 9 %, të biologjisë dhe fizikës me nga 7.9%. Ndërsa mësimdhënës të kimisë, matematikës dhe edukatës figurative janë përfshirë 6.7% dhe nga gjuha shqipe dhe gjeografia me nga 4.5 %.


---

## II. REZULTATET ME MËSIMDHËNËS

Mësimdhënësit e përfshirë në këtë hulumtim janë mësimdhënës klasorë dhe mësimdhënës lëndorë. Nga mësimdhënësit e anketuar, në një numër pak më të madh të mësimdhënësve janë ata klasorë, me 19 %, kurse të tjerët kanë përqindje më të ulët. Mësimdhënësit e gjuhës angleze përfaqësohen me 13.5 %, të historisë me 10.1 %, të teknologjisë 9 %, të biologjisë dhe fizikës me nga 7.9 %. Mësimdhënësit e kimisë, matematikës dhe të edukatës figurative janë përfshirë 6.7 %, kurse përqindja e mësimdhënësve të gjuhës shqipe dhe të gjeografisë ishte 4.5%.

### *Mësimdhënësit lëndorë dhe klasorë të përfshirë në hulumtim*

Graf. 1





---


Arsyeja se pse mësimdhënësit lëndorë janë të përfshirë në këtë hulumtim është që të informohemi për atë se sa po përfshihet teknologjia informative gjatë procesit të mësimdhënies dhe të nxënies në lëndët e ndryshme mësimore, duke u bazuar në atë se edhe shkencat shoqërore e edhe ato shkencore, që të dyja janë rëndësishme për integrimin e vazhdueshëm të TIK-ut në fushën e arsimit. Mësimdhënësit e këtyre fushave, përmes integritit të TIK-ut në mësimdhënie, mund të kryejnë aktivitete të ndryshme mësimore, duke u bazuar në praktika të suksesshme me prioritete arsimore. Po ashtu edhe mësimdhënësit klasorë janë përfshirë në këtë studim për arsye se këta mësimdhënës duhet të përgatisin nxënësit për përdorimin e drejtë të TIK-ut, në mënyrë që ata të jenë të gatshëm qenë klasat në vijim të dinë të komunikojnë dhe ta zbatojnë TIK-un për mësim.

Mësimdhënësit që kanë qenë të përfshirë në këtë hulumtim, janë mësimdhënës të ciklit fillor dhe të ciklit të mesëm të ulët. Përzgjedhje e këtyre mësimdhënësve është bërë për arsye se shumica e mësimdhënësve që japin mësim në këtë cikël janë të trajnuar për përdorimin e teknologjisë informative të komunikimit. Po ashtu kriter i hulumtimit të realizuar ishte edhe ajo se nxënësit bazën e arsimit e marrin nga shkolla fillore dhe ajo e ciklit të mesëm të ulët. Po ashtu mësimdhënësit e këtij niveli që në fillim të fëmijërisë së tyre të hershme duhet t'i përgatisin nxënësit, që ata përdorin sa më drejt ta teknologjinë informative të komunikimit.

---

## Klasat e përfshirë në hulumtim (mësimdhënësit)

Graf. 2



Nga kjo që është paraqitur, shohim se mësimdhënësit klasorë që kanë marrë pjesë në këtë studim janë: 18,9%, mësimdhënësit të klasave gjashta 16,7%, mësimdhënësit të klasave të shtata 23,3%, mësimdhënësit të klasave të teta dhe 24,4% dhe mësimdhënësit të klasave të nënta 16,7%. Ndërsa, sa i përket strukturës gjinore të mësimdhënësitve pjesëmarrës në anketim është: 66.6% të gjinisë femërore dhe 34% të gjinisë mashkullore.


### 2.1. Pajisja e shkollave me kompjuterë

Shumë shkolla janë furnizuar me laboratorë kompjuterik. Në shkollat e mesme mesatarja e laboratorëve kompjuterik është si vijon: shkollat profesionale 1.52 laboratorë (35.15 kompjuterë); shkollat e përgjithshme – 1.2 laboratorë (32 kompjuterë); shkollat e përziera – 1.4 laboratorë (24.8 kompjuterë); qendrat e kompetencës – 6 laboratorë (312 kompjuterë). Rreth 60% e të

---

gjitha shkollave të nivelit para universitar janë të pajisura me laboratorë të teknologjisë informative. Pjesa e mbetur do të pajiset gjatë 2-3 viteve në vijimin<sup>12</sup>. Pyetjes se a është shkolla juaj e pajisur me kompjuterë, 64.8% prej tyre i janë përgjigjur se shkolla ku ata punojnë ka kompjuterë, kurse 35.2% thonë se nuk ka.

Graf. 3



Përveç përgjigjeve që janë cekur më lart, mësimdhënësit kanë dhënë edhe opinione të ndryshme, duke pohuar se kompjuteri është i nevojshëm nëpër shkolla, por nuk kemi kushte për një gjë të tillë, sepse në një klasë janë mbi 30 nxënës dhe shkolla nuk ka asnjë kabinet e as laborator, atëherë si mund të ketë sukses ky lloj mësimi. Përveç kësaj, përkitazi me këtë pyetje, mësimdhënësit janë deklaruar: „*Ne nuk kemi kushte elementare në shkollë, nuk kemi ujë, mungon higjiena, e për teknologji neve nuk jemi të interesuar shumë, se a ka shkolla jonë kompjuter apo jo. Kishte qenë mirë që së pari të na rregulloni kushtet për higjienë e për ujë, e atëherë, kur të na*

---

<sup>12</sup><http://www.meiks.net/repository/docs/> (parë për herë të fundit 12 qershor 2013 )


---

*plotësohen këto kushte, ju lirisht mund të vini, e ne atëherë jemi të gatshëm të bisedojmë për këtë temë.“*

### **2.3. Njohuritë e mësimitdhënësve për përdorimin e kompjuterit**

Në grafikun e mëposhtëm është paraqitur shkalla e njohurive të mësimitdhënësve në përdorimin e kompjuterit. Prej tyre 38.9% deklarohen se kanë njohuri të mjaftueshme, 32.2% njohuri shumë të mira, kurse 28.9% shprehen se posedojnë njohuritë fillestare në përdorimin e tij.

Graf. 4



Sipas këtyre të dhënave, shihet se gjendja e mësuesve për njohuritë e përdorimit të kompjuterit është në nivel të mjaftueshëm, sepse çështje kryesore dhe thelbësore për përfshirjen e TIK-ut në mësimitdhënie dhe nxënie është më shumë përqendrimi i mësimitdhënësve në shfrytëzimin e TIK-ut për qëllime arsimore, se sa shfrytëzimi praktik i kompjuterëve bashkë me mjetet dhe programet e tij. Për përdorimin sa më shumë të kompjuterit, shkolla duhet të përcaktohet për një

---

program. Mësuesve u nevojiten (80%) shprehi jo teknike dhe (20%) shprehi teknike. Thelbësore është pavarësia dhe puna në grupe. Shprehitë baza të nevojshme (të lexuarit, të shkruarit, skicimi) dhe shprehi të tjera të nivelit të lartë të njohjes janë kushte paraprake për një përdorim të suksesshëm të TIK-ut.


## **2.4. Vijimi i mësimdhënësve në trajnime për TIK**

Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë në bashkëpunim me donatorët ka punuar në zhvillimin e burimeve njerëzore duke ofruar trajnime në ECDL (European Computer Driving Licence). „Rreth 10,700 mësimdhënës kanë përfunduar këtë trajnim. Gjithashtu, progres i konsiderueshëm është arritur në investimet infrastrukturore të cilat kanë ndikuar në përmirësimin e situatës<sup>13</sup>. Integrimi i TIK-ut, zakonisht nënkupton trajnimin e mësimdhënësve, por gjithashtu kërkon një vizion më të gjerë të zhvillimit të kompetencave dhe të shërbimeve mbështetëse brenda institucioneve arsimore. Pyetjes *A keni të kryer trajnime për TIK*, 67.8% e mësimdhënësve iu përgjigjen se kanë të kryer kurse, ndërsa 32.2% nuk kanë të kryer asnjë kurs për TIK. Të dhënat janë të paraqitura në grafikun në vijim.

---

<sup>13</sup><http://www.meiks.net/repository/docs> (parë për herë të fundit me 9.12.2013)

Graf. 5



Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të mësimdhënësve për përdorimin e kompjuterit në procesin e mësimdhënies dhe të nxënies, që nga viti 2009 MASHT-i ka kontraktuar me shumë organizata dhe me Universitetin Amerikan të Kosovës (AUK) për përgatitjen profesionale të mësimdhënësve për programin: Patenta Evropiane për Përdorimin e Kompjuterit (ECDL), që njihet si standard ndërkombëtar për aftësitë kompjuterike. Përveç këtij programi, organizatat dhe institucionet e tjera kombëtare dhe ndërkombëtare kanë trajnuar mësimdhënësit për përdorimin e kompjuterit gjatë procesit mësimor.


## 2.5. Organizatat që kanë ofruar trajnime për TIK-un

Përgatitja e mësimdhënësve për përdorimin e TIK-ut është një objektiv shumë i rëndësishëm i politikave arsimore. Këtyre çështjeve i janë drejtuar disa organizata ndërkombëtare me projekte të tilla, siç është: ECDL që e ka realizuar MASHT, së bashku me AUK-un. Organizatat që kanë trajnuar mësuesit, të cilët kanë qenë pjesëmarrës të këtij hulumtimi, sipas

---

opinioneve të mësimeve, janë të paraqitura në grafikun në vijim.

Graf. 6



Përkitazi me ofrimin e trajnimeve nga organizata dhe institucione të ndryshme, 74.2% shprehen se organizatat kanë ofruar trajnime për kompjuterë, kurse 25.8% përgjigjen se ato nuk e kanë bërë këtë. Organizatat të cilat kanë ofruar trajnime ECDL si kontraktorë të MASHT-it, janë AUK-u, USAID-i, Don Boskoja dhe Educ Aid-i. Pjesën më të madhe të këtyre trajnimeve apo 87.7% e ka organizuar AUK – u. Në trajnime të USAID – it dhe Educ Aid – it janë përfshirë 6.2%, përkatësisht 4.6% të mësimeve, siç shihet edhe nga grafiku i më sipërm.


## 2.6. Programet kompjuterike që i zbatojnë mësimeve

Programet të cilat më së tepërmi i përdorin mësimeve janë 7 modulet që përfshijnë ECDL-i. Prej tyre programi me një përqindje më të madhe që e përdorin mësimeve është Word me 85.7 %, Excel-i (program për tabela dhe kalkulime) që përdorin 63.1% të mësimeve, kurse PowerPoint-in

58.3% prej tyre. Interneti dhe Access-i përfaqësohen me një përqindje më të vogël, 33.3 përkatësisht 26.2 %. Dy të anketuar kanë deklaruar se nuk përdorin asnjërin prej këtyre programeve.

Graf. 7

### Programet kompjuterike që i përdorin mësimmhënësit



Nga rezultatet e paraqitura shohim se mësimmhënësit, kanë përfituar nga trajnimi ECDL. Gati në çdo profil profesional programi i ECDL ofron një platformë mjaft të përshtatshme për fitimin dhe zhvillimin e njohurive dhe të aftësive për përdorimin e kompjuterit . Ndër të tjera, përfitimi dhe aftësimi për përdorimin e kompjuterit përmes programit të ECDL-së ka një njohje të lartë internacionale dhe kjo e bën më të veçantë këtë program. Zbatimi i tij po zë vend gjithnjë e më shumë në institucionet publike dhe private të çdo vendi.



---

## 2.7. Integrimi i teknologjisë informative të komunikimit në mësimdhënie

Pyetjes, *si e përfshini teknologjinë mësimore në mësimdhënie?* 25.6% e mësimdhënësve i janë përgjigjur: me ilustrimin dhe konkretizimin e përmbajtjeve mësimore, kurse 17.1% për konsultimin e literaturës shkollore për të cilën thonë se u mungon, pa e dhënë opinionin e tyre se për çfarë lënde. Me një përqindje më të ulët (13.4) përfaqësohen mësimdhënësit të cilët këtë ndihmë e shfrytëzojnë për përgatitjen dhe prezantimin e temave të ndryshme me foto, tabela, diagrame etj, kurse me nga një përqindje përafërsisht të njëjtë prej 6 deri në 8.5% kanë deklaruar se atyre kompjuteri u ndihmon për hulumtime dhe për të përcjellë metodat e reja në fushën e mësimdhënies, për hartimin e projekteve të ndryshme, për pajisjen me informata shtesë, me të cilat tema bëhet më interesante. Mënyrë tjetër është edhe mësimi përmes lojërave të ndryshme, që ka për qëllim për të bërë një mësimdhënie më atraktive, si dhe analizimi i materialeve të marra nga interneti, siç tregon edhe tabela në vijim.

Tabela

	Përqindja
Për ilustrimin dhe konkretizimin e përmbajtjeve mësimore.	25.6
Për përgatitjen dhe prezantimin e temave të ndryshme me foto, diagrame, tabela etj.	13.4
Për hulumtime dhe për të përcjellë metodat e reja në fushën e mësimdhënies.	8.5

Për konsultimin e literaturës shkollore e cila mungon.	17.1
Për hartimin e projekteve të ndryshme.	7.3
Për komunikim me e-mail.	6.1
Për pajisjen me informata shtesë me anë të fotove të ndryshme me të cilat tema bëhet më interesante.	7.3
Hartimin e testeve.	6.1
Në hartimin e planeve dhe të programeve dhe të ushtrimeve të ndryshme.	1.2
Për mësimdhënie më atraktive përmes lojërave të ndryshme apo shikimi i materialeve të marra nga interneti.	6.1
Për diagrame në statistikë dhe për tabela të ndryshme.	1.2

## **2.8. Metodën mësimore përmes TIK-ut që zbatojnë mësimdhënësit gjatë procesit mësimor**

Opinionet e mësimdhënësve për metodat e zhvillimit të mësimin përmes TIK-ut janë të ndryshme. 35.5% të mësimdhënësve kanë deklaruar se ata i udhëzojnë nxënësit, duke i orientuar në adresa të ndryshme për të hulumtuar për tema mësimore. Këto tema pastaj në klasë do të diskutohen dhe do të plotësohen edhe nga nxënësit e tjerë. Një numër i konsiderueshëm i mësimdhënësve thonë se ata i udhëzojnë nxënësit se si të përdorin internetin për detyra shtëpie dhe mënyrën se si duhet hulumtuar në shtëpi. Mënyra të tjera të zhvillimit të mësimin janë: prezantimi i temave të caktuara me foto, harta, skica, tabela, në PowerPoint, zhvillimi i mësimin

përmes CD–ve etj. Tabela në vazhdim paraqet përgjigjet e mësimeve të shprehura në përqindje.

Tabela

	Përqindja
Përmes CD-së.	11.3
Nxënësit orientohen në adresa të ndryshme për të hulumtuar përkitazi me temat mësimore e pastaj në klasë bëhen pyetje rreth atyre temave.	35.5
Ata përdorin internetin sipas udhëzimeve tona që u japim atyre për detyrë shtëpie dhe mënyrën se si duhet punuar në shtëpi.	21.0
Për tema të caktuara ata marrin informacione të pavarura plotësuese nga interneti.	17.7
Prezantimi i temave të caktuara me foto, harta, skica, tabela etj. në PowerPoint.	12.9
Me futjen e teknologjisë në sistemin arsimor shumë nxënës mund të zhvillojnë mësimin nga distanca (online).	1.6

Përqindja e mësimeve të shprehura që i udhëzojnë nxënësit për përdorimin e teknologjisë informative për mësim është si në vijim: 35%. të mësimeve të shprehura i orientojnë nxënësit në adresa të ndryshme, për të hulumtuar përkitazi me temat mësimore, e pastaj zhvillimi i orës bëhet duke debatuar rreth atyre temave që janë hulumtuar në internet. Mësimeve të shprehura deklarohen se 11.3% i udhëzojnë nxënësit që përmes CD-së të mësojnë, e veçanërisht ky opinion ka qenë i mësimeve të shprehura të gjuhës

---

angleze, të cilët përmes CD-së i udhëzojnë nxënësit të mësojnë gjuhën angleze. 21% të mësimitdhënësve japin detyra të shtëpisë, duke i udhëzuar që TIK-un ta integrojnë për detyra të shtëpisë. 17.7% të mësimitdhënësve i udhëzojnë dhe i caktojnë tema për të cilat duhet të hulumtojnë në internet. Përqindja e mësimitdhënësve të cilët e integrojnë PowerPoint-in gjatë procesit të mësimitdhënies dhe nxënies është 12.9%. Ndërkaq 1.6% të mësimitdhënësve shprehen se me përdorimin e teknologjisë informative në mësimitdhënie mund të zhvillojnë edhe mësimin nga distanca.

## **2.9. A mësojnë nxënësit përmes kompjuterit në klasë dhe në shtëpi me udhëzime të mësimitdhënësve ?**

Pyetjes se a mund të zhvillohet mësimi në klasë apo në shtëpi nga nxënësit me udhëzimet tuaja, 78.2% të mësimitdhënësve i janë përgjigjur se mësimi mund të zhvillohet, kurse 21.8% prej tyre e kanë mohuar këtë.

Graf. 8



Përveç këtyre rezultateve që kemi marrë nga mësimitdhënësit, ne kemi arritur të marrim edhe komentet e tyre. Mësimitdhënësit deklaruan se mësimi përmes kompjuterit mund të zhvillohet

---

edhe në shtëpi me udhëzimet e tyre, mirëpo kërkojnë nga prindërit e nxënësve, që të vëzhgohen fëmijët e tyre me vëmendje, për atë se sa kohë dhe për çfarë po e përdorin kompjuterin. Po ashtu kërkojmë nga prindërit që t’iu kufizohet koha dhe të jenë nën kontroll të tyre, për arsye se kanë vënë re në gjatë procesit mësimor se ata janë duke e keqpërdorur kompjuterin, sidomos duke e humbur kohën në facebook. Meqenëse disa mësimdhënës janë përgjigjur se nuk janë duke e integruar Tik-un në procesin e mësimdhënies dhe të nxënies, atëherë pyetja jonë ishte se cilat ishin arsyet që ju nuk e praktikoni TIK-un gjatë mësimdhënies. Përgjigjet e tyre janë si në vijim.

## **2.10. Disa arsye të mësimdhënësve që nuk e zbatojnë TIK-un për mësimdhënie dhe nxënie**

Pyetjes plotësuese se cilat janë arsyet se pse mësimdhënësit nuk e integrojnë TIK-un në mësim, mësimdhënësit i janë përgjigjur me përqindjet si në vijim.

42% të mësimdhënësve nuk kërkojnë nga nxënësit të sjellin punime fare nga interneti, apo thënë ndryshe nuk e integrojnë TIK-un në procesin e mësimdhënies. Nga përgjigjet e mësimdhënësve rezulton se një pjesë e konsiderueshme e mësimdhënësve apo 41.7% si arsye kryesore pse nuk e bëjnë këtë konsiderojnë se nxënësit nuk kanë kompjuterë në shtëpitë e tyre, 30.6% deklarojnë se libri mjafton në arritjen e rezultateve të dëshiruara, kurse 13.9% shprehen se nxënësit nuk kanë njohuri për përdorimin e kompjuterit për nevoja mësimore. Disa nga mësimdhënësit përgjigjen se ata nuk dëshirojnë t’i ngarkojnë nxënësit me detyra të shtëpisë. Në tabelën në vijim janë të paraqitura arsyet kryesore se pse

mësimdhënësit nuk e integrojnë teknologjinë informative të komunikimit gjatë procesit të mësimdhënies.

Tabela

	Përqindja
Nuk e preferoj fare zbatimin e TIK-ut në mësimdhënie dhe nxënie.	2.8
Nuk e zbatoj, sepse unë punoj vetëm në klasë, e nxënësit punimet i zgjedhin vetë, kurse unë nuk i ngarkoj ata me detyra të shtëpisë.	8.3
Ka nxënës që u mungon kompjuteri.	41.7
Mendoj se libri mjafton në arritjen e rezultateve që dëshirojmë.	30.6
Puna e kompjuterit ka pak të bëjë me lëndën e edukatës fizike.	2.8
Sepse nxënësit nuk dinë ta përdorin për nevoja mësimore.	13.9

Meqenëse një numër i konsiderueshëm i mësimdhënësve nuk e integrojnë TIK-un në mësimdhënie, edhe pse roli dhe rëndësia e tij është shumë e madhe, për arsye se përmes integrimit të TIK-ut në detyrat e shtëpisë bëhet aktivizimi i drejtpërdrejtë dhe i pavarur i nxënësve për përf forcimin e lëndës mësimore pa mbikëqyrje nga ana e mësimdhënësit. Detyrat e shtëpisë ndikojnë në zgjerimin e njohurive dhe realizohen në mënyrë të pavarur nga puna e planifikuar me plan dhe me program. Roli i përdorimit të teknologjisë informative për detyrat e shtëpisë të nxënësve është shumë i rëndësishëm, për arsye se mundëson që nxënësit, përveç zgjidhjes së detyrave përmes librave, mund të përdorin edhe internetin, duke hulumtuar dhe duke zgjeruar

---

njohuritë e tyre për një çështje apo lëndë mësimore. Përmes kësaj ata mund të mësohen se si të përdorin burime nga interneti. Roli i mësimdhënësve në këtë rast është orientues, ata mund të kërkojnë nga nxënësit hulumtime në internet përtema të caktuara mësimore, në mënyrë që t'i stimulojnë që internetin ta përdorin për nevoja pedagogjike. Nga mësimdhënësit kërkohet që gjatë procesit mësimor të përdorin strategji të ndryshme të mësimdhënies dhe nxënies, ata kanë nevojë të përtërijnë metodat e tyre tradicionale. Mësimdhënia bashkëkohore kërkon që të ketë llojllojshmëri të mënyrave për mësimnxënie.

Në qoftëse mësimdhënësit i stimulojnë nxënësit që ta përdorin kompjuterin në mënyrë edukative edhe në shtëpi, duke u bazuar se sot gati të gjithë fëmijët janë të pajisur me kompjuter, atëherë edhe prindërit do të jenë të vetëdijshëm se për çka e përdorin fëmijët e tyre atë. Për të integruar TIK-un për nevoja pedagogjike në shtëpi, gjithnjë kërkohet orientim dhe vlerësim nga mësimdhënësit, si dhe mbikëqyrje nga prindërit.

## **2.11. Përdorimi i TIK- ut nga fëmijët me nevoja të veçanta**

Pyetjes së parashtruar për mësimdhënësit se a është TIK-u mjet stimulues për nxënësit me aftësi të kufizuar, 87.2% të mësimdhënësve theksojnë se po. TIK-u është mjet stimulues i cili ndikon në ngritjen e nivelit të nxënësve, mirëpo nuk ka pajisje teknologjike që janë të posaçme për këta fëmijë. Për të tjerët, kjo shihet si nxitje e kureshtjes dhe një mënyrë më e përshtatshme se sa shfletimi i burimeve të tjera. Për një numër më të vogël mësimdhënësish është mjet stimulues, por kërkohet ndihma e mësimdhënësit, kurse 11.8% mendojnë se ai

---

nuk është mjet stimulues, e madje një numër i vogël prej tyre kanë deklaruar se paraqet vështirësi në nxënie.

Në tabelën në vijim, janë evidencuar opinionet e mësimeve përkitazi me përdorimin e kompjuterit si mjet stimulues për fëmijët me nevoja të veçanta.

Tabela

	Përqindja
Po, është mjet stimulues dhe më i lehtë për nxënësin dhe ndikon në ngritjen e nivelit të tij.	33.5
Është mjet stimulues që e nxit kureshtjen e nxënësve dhe e thyen monotoninë e rutinës duke shfletuar burime.	28.5
Është mjet stimulues por kërkohet ndihma e mësimeve.	10.2
Po, sepse është më tërheqës për ta.	11.2
Nëse përdoret me kufi dhe për mësim.	4.8
Nuk është mjet stimulues.	11.8

Sipas rezultateve të paraqitura më lart, TIK-u ka kontribuar dhe mund të kontribuojë, përfshirë këtu edhe arsimin e veçantë, ku përpjekje të mëtejshme duhet të bëhen për arsimimin gjithëpërfshirës. Por shumë vëmendje duhet t'u kushtohet njerëzve me arritje të ulëta. Gjithëpërfshirja mund të ketë pengesa për shkak të kushteve sociale dhe edukative të shfrytëzimit të TIK-ut në procesin arsimor.




---

## 2.12. Sa ju ofrojnë mësimdhënësit material shtesë nga interneti

Pyetjes së shtruar mësimdhënësve se a ju ofroni material shtesë nxënësve nga interneti, mësimdhënësit janë deklaruar se: 27.3% e tyre ju ofrojnë material shtesë nga interneti, kurse 72.7%, prej tyre deklarohen se nuk u kanë ofruar kurrfarë materialesh nga interneti nxënësve të tyre.

Graf. 9



Nga përgjigjet e mësimdhënësve rezulton se 27.3% internetin e përdorin për të kërkuar të dhëna rreth njësive mësimore, të cilat nuk mund t'i gjejnë në libra. Në këtë rast ata janë përgjigjur varësisht nga lënda e mësimdhënies se kanë hulumtuar faqe të caktuara të internetit duke shënuar madje edhe adresat, p.sh. disa mësimdhënës të biologjisë, gjuhës angleze dhe të teknologjisë. Rreth 20% prej tyre internetin e përdorin për t'u njoftuar me informacionet më të reja që ndodhin në botë. Për teste, për ushtrime dhe informacione të tjera që lidhen me

lëndën e caktuar e përdorin 13.3%, të mësimdhënësve, kryesisht mësimdhënësit e gjuhës angleze dhe disa të matematikës, kurse për hulumtime shkencore në web faqe të ndryshme 10.1%. Për komunikim me prindërit dhe me nxënësit rreth çështjeve mësimore e përdorin 11.4%, për ngritje profesionale 11.1% dhe me një përqindje tepër të vogël e përdorin mësimdhënësit për shfletim të gazetave dhe për nevoja personale, ndërsa 12.2% të mësimdhënësve nuk kanë dhënë fare përgjigje.

### 2.13. Përdorimi i internetit nga mësimdhënësit

Tabela 5.

	<b>Përqindja</b>
Për hulumtime shkencore në web faqe të ndryshme.	10.1
Për të kërkuar të dhëna rreth njësive mësimore, të cilat nuk mund të gjinden në libra.	25.3
Për informacionet më të reja që ndodhin në botë	20.3
Për teste, për ushtrime dhe për shumë gjëra që lidhen me lëndën time.	15.2
Për ngritje profesionale.	12.7
Për komunikim me prindërit dhe nxënësit rreth çështjeve mësimore.	11.4
Për shfletim të gazetave.	2.5
Për nevoja personale.	2.5

---


Sipas rezultateve të cekura më lart mund të konkludojmë se interneti është një mjet lehtësues për mësimdhënie. Mësimdhënësit kanë pohuar se interneti na ndihmon dhe na ofron mënyra të llojlojshme të të nxënies. Nxënësve u mundëson të hulumtojnë në mënyrë të pavarur për të gjitha lëndët mësimore. Përveç tekstit që kanë në duar, mësimdhënësit dhe nxënësit, interneti iu mundëson edhe gjetjen e të dhënave të ndryshme me burime plotësuese të informacioneve. Përveç kësaj, mësimdhënësit shprehen se interneti lehtëson bashkëpunimin nëmes të prindërve dhe nxënësve, duke e zvogëluar nevojën që nxënësit të jenë në vendin e njëjtë. Mirëpo mësimdhënësit deklarohen se mungon interesimi i nxënësve për bashkëpunim, sepse shumicën e kohës e kalojnë duke e përdorur internetin për lojëra dhe bisedime të ndryshme. Duke u bazuar në këtë, mund të themi se roli i mësimdhënësve në stimulimin e nxënësve për përdorimin e internetit nëmësim është shumë i rëndësishëm. Ka mënyra të ndryshme që mësimdhënësit mund t'i stimulojnë nxënësit për përdorimin e drejtë të internetit. Ata duhet të kërkojnë nga nxënësit që komunikimin midis tyre ta bëjnë përmes e-mail-it. Kjo është vetëm një mënyrë e komunikimit, që nxënësit, sidomos ata të klasave të ulëta, i mëson për përdorimin e e-mail-it. Përveç kësaj, nxënësit duhet të edukohen për përdorimin në mënyrë pedagogjike të internetit, që do të ndikojë në mësimin e tyre gjatë gjithë jetës.

---

## 2.14. Sa i udhëzojnë mësimitdhënësit nxënësit për hulumtime në internet për nevoja mësimore

Përkitazi me rolin e mësimitdhënësve në angazhimin e nxënësve për hulumtime në internet për nevoja mësimore, 58% e mësimitdhënësve kanë deklaruar se roli i tyre është që të udhëzojnë nxënësit, që ata të sjellin punime nga interneti, ndërsa 42% prej tyre thonë se ata nuk e bëjnë një gjë të tillë.

Graf. 10



Roli i mësimitdhënësve në angazhimin e nxënësve për hulumtime në internet është jashtëzakonisht i madh. Mësimitdhënësit duhet t'i stimulojnë nxënësit që të jenë të vëmendshëm ndaj elementëve pamorë dhe burimeve mediatike dhe të dallojnë informacionin që duhet të mësohet dhe përshtypjet që duhet të krijohen nga imazhet dhe tingujt.

Nga mësimitdhënësit kërkohet që t'i nxisin nxënësit për kërkime në internet për informacione rreth një teme, demonstrime përmes videove, vjersha, tregime dhe shkrime të shkurtra letrare ose

---

joletrare. Nxënësit të ndarë në grupe të vogla mund të lexojnë, të analizojnë dhe të diskutojnë për revista, gazeta, artikuj kontradiktorë, për të cilët kanë interesim të gjithë dhe që kanë hasur në internet.

## 2.15. Materialet ndihmëse nga interneti

Pyetjes plotësuese për mësimdhënësit se çfarë materialesh ju ofroni nxënësve për t'i stimuluar që ata internetin ta përdorin për nevoja mësimore, 20.6% prej tyre janë shprehur se kanë ofruar tema që lidhen me njësinë mësimore, 17.5% informacione të ndryshme që kanë të bëjnë me lëndën e tyre, kurse 9.5% informacione të ndryshme që kanë të bëjnë me jetën e përditshme. Me një përqindje përafërsisht të njëjtë, 6 deri në 8% janë përfaqësuar mësimdhënësit të cilët nxënësve u ofrojnë udhëzime për hulumtime, adresa dhe faqe interneti për shfrytëzim të literaturës, modele të ndryshme të punuara sipas faqeve të ndryshme të internetit, të cilat shërbejnë për punë dore nga nxënësit, materiale të ndryshme, vizatime, skica, fotografi që lidhen me njësitë mësimore, teste të ndryshme, detyra dhe ushtrime të paplotësuara lidhur me njësinë mësimore, si dhe prezantime me video projektor për lëndën përkatëse .

Tabela

	Përqindja
Modele të ndryshme për punë praktike,që i prezantojmë me video projektor.	3.2

Informacione të ndryshme, që kanë të bëjnë me lëndën time.	17.5
Në shkollë nuk kemi kushte, por ndonjëherë u ofrojmë punime të cilat i marrim prej internetit në shtëpi e po ashtu edhe nxënësit angazhohen vetë për një gjë të këtillë.	4.8
Varet nga njësia mësimore.	3.2
Tema që lidhen me njësinë mësimore.	20.6
Modele të ndryshme të punuara sipas faqeve të ndryshme të internetit, të cilat na shërbejnë për punë dore nga nxënësit.	6.3
Informacione të ndryshme që kanë të bëjnë me jetën e përditshme.	9.5
Udhëzime për hulumtime.	7.9
Materiale të ndryshme, vizatime, skica, fotografi që lidhen me njësitë mësimore.	6.3
Adresa dhe faqe interneti për shfrytëzim të literaturës.	7.9
U ofroj detyra dhe ushtrime të paplotësuara lidhur me njësinë mësimore.	4.8
Teste të ndryshme.	7.9

Mësimdhënësit kanë dhënë përgjigje të ndryshme, varësisht prej lëndës të cilën e japin. Për ofrimin e testeve të ndryshme, detyrave, si dhe ushtrimeve të pa plotësuara, janë deklaruar kryesisht mësimdhënësit e gjuhës angleze dhe të matematikës, kurse prezantime me video projektor përdorin mësimdhënësit e

---

disa lëndëve, e veçanërisht mësimdhënësit e gjuhës shqipe. Mësimdhënësit e biologjisë u afrojnë nxënësve të tyre njësi që kanë të bëjnë me botën bimore dhe shtazore, të gjeografisë ilustrime nga vende të ndryshme të botës, kurse të historisë ngjarje apo dokumente të ndryshme.

## **2.16. Sa janë të informuar mësimdhënësit se për çfarë arsye nxënësit e përdorin internetin**

Pyetjes se për çfarë e përdorin internetin nxënësit gati gjysma e mësimdhënësve të anketuar kanë deklaruar se ata e përdorin internetin për lojëra dhe Facebook, varësisht se si e kanë specifikuar vetë mësimdhënësit. 15.6% të mësimdhënësve deklarohen se nxënësit e tyre internetin e përdorin për qëllim të mësimin, kurse 10.6% për informacione të ndryshme në fusha të ndryshme. Rreth 8% prej tyre janë përgjigjur se nxënësit e përdorin internetin për informacione të reja duke theksuar se gjatë zhvillimit të njësive mësimore ata shpesh në orët e mësimin kontribuojnë me informacione të reja të cilat i kanë marrë nga interneti, kurse 6.7% të mësimdhënësve mendojnë se nxënësit e përdorin shumë pak internetin për mësim, ata e përdorin për komunikim midis tyre dhe për lojëra, ndërsa 9.4% të mësimdhënësve shprehen se nuk kanë njohuri se për çfarë e përdorin nxënësit e tyre internetin.

Tabela

	Përqindja
Ata e përdorin për qëllime mësimi.	16.5
E përdorin për informacione të reja, sepse gjatë zhvillimit të temës mësimore nxënësit shpesh gjatë orës kontribuojnë me informacione të reja të marra nga interneti.	8.2
Për informacione të ndryshme në fusha të ndryshme.	10.6
Nxënësit e përdorin shumë pak internetin për mësim, ata më tepër e përdorin për komunikim midis tyre dhe për lojëra.	7.1
Për Facebook.	28,3
Për lojëra.	20.0
Nuk jam i/e informuar.	9.3

Duke u bazuar në këto të dhëna të këtij hulumtimi, apo në përgjigjet që kemi marrë nga mësimdhënësit, ne mund të vijmë në përfundim se të nxënësit mungojnë kompetencat për TIK-un. Nxënësit, duke filluar nga klasat e ulëta, duhet të jenë në gjendje që të kërkojnë informacione në mënyrë të detajuar dhe të praktikojnë më shumë njohuritë dhe aftësitë e tyre për të qenë njohës më të mirë të specifikave kompjuterike. Në klasën e gjashtë nxënësit fillojnë të njohin edhe përmbajtjen e Excel-it. Ndërkaq në klasën e shtatë është e rëndësishme që t'i kushtohet rëndësi aftësive bazë, si dhe mësimdhënësit të kërkojnë nga nxënësit të thellojnë të kuptuarit e tyre.



---

## 2.17. Rëndësia e internetit për mësim

Pyetjes plotësuese se ku qëndron rëndësia në angazhimin e nxënësve në përdorimin e internetit për hulumtime dhe nevoja tjera mësimore, mësimdhënësit i janë përgjigjur jo njësoj.

Numri më i madh i mësimdhënësve (32 %) janë shprehur se ata kërkojnë nga nxënësit hulumtime në internet për detyra të shtëpisë, me qëllim të zgjerimit të njohurive, lidhur me njësitë mësimore, kurse 20% prej tyre e bëjnë këtë për arsye se në internet mund të gjenden gjëra të cilat e bëjnë orën edhe më atraktive. Ndërkaq për punimin e projekteve të ndryshme janë deklaruar 12% e mësimdhënësve. Me nga një përqindje prej 10% janë përfaqësuar mësimdhënësit të cilët thonë se i angazhojnë nxënësit për hulumtime në internet për ngritjen e vetëdijes, që të bëhen hulumtues përkitazi me atë se çfarë mësojnë dhe që ora të jetë më interesante për nxënësit gjatë prezantimit të detyrave të shtëpisë në klasë. Në bazë të kësaj mësimdhënësit janë shprehur: “Ne do të informohemi se për çfarë tema janë më shumë të interesuar nxënësit, që ne më tutje të vazhdojmë me shtjellimin e atyre temave që ata kanë hulumtuar”. Arsye të tjera për të cilat janë përcaktuar mësimdhënësit në kërkim të këtyre detyrave janë angazhimi i nxënësve që nga interneti të sjellin punime të cilat i prezantojnë në klasë me video projektor apo me forma të tjera të prezantimit. Ndërkaq 8% e mësimdhënësve janë shprehur se i angazhojnë nxënësit për hulumtime në internet, për arsye të stimulimit të atyre nxënësve që janë më pak aktivë. Në tabelën në vijim janë të paraqitura përqindjet e mësimdhënësve, që i janë përgjigjur pyetësorit në pyetjen për rëndësinë e angazhimit të nxënësve për hulumtime në internet.

Tabela

	Përqindja
Për punimin e projekteve të ndryshme.	12.0
Në internet mund të gjinden gjëra të cilat e bëjnë orën edhe më atraktive.	20.0
Për zgjerimin e njohurive lidhur me njësitet mësimore.	32.0
Për ngritjen e vetëdijes që të bëhen hulumtues përkritazi me atë se çfarë mësojnë.	10.0
Që ora të jetë më interesante për nxënës, gjatë prezantimit të detyrave të shtëpisë në klasë. Aty do të vërehet se sa për çka janë më shumë të interesuar nxënësit në mënyrë që ne të ndalemi më tepër në ato tema.	10.0
Për angazhimin e tyre që nga interneti ata të sjellin punime të cilat i prezantojnë në klasë me video projektor apo forma tjera të prezantimit.	8.0
Për të nxitur angazhimin e nxënësve pasivë.	8.0


---

### III. REZULTATET ME NXËNËS

#### 3.1. Klasat e përfshira në hulumtim

Në hulumtim janë përfshirë, siç shihet edhe nga grafiku i mëposhtëm, 187 nxënës të klasave të nënta dhe 48 të klasave të shtata. Prej tyre 118 vajza apo 50.9%, dhe 114 meshkuj apo 49.1 %. Nxënësit kanë qenë të moshës adoleshente, sepse adoleshentët janë duke humbur shumë orë të tëra pranë internetit, duke shikuar programe me përmbajtje jo edukative për jetën e tyre, ndërsa hulumtimet për nevoja shkollore në internet, si dhe libri si esencë për edukim dhe zhvillim, shumë pak apo aspak po zë hapësirë në duart e tyre. Në vazhdim të punimit do të paraqesim edhe të dhënat për përdorimin e TIK-ut nga nxënësit dhe ndikimin e tij në mësimdhënie dhe nxënie.

Graf. 11




---

### 3.2. Pajisja e shkollave me kompjuterë

Pyetjes se a është e pajisur shkolla me kompjuterë apo jo, 68.9% të nxënësve janë përgjigjur se shkolla në të cilën ata vijnë në mësim, ka kompjuterë, kurse 31.1% thonë se nuk ka.

Graf. 12



Ndërkaq sa u përket përgjigjeve të mësimdhënësve, 64.8% prej tyre kanë thënë se shkollat ku punojnë ata janë të pajisura me kompjuterë, kurse 35.2% thonë se nuk ka.

### 3.3. Kurset për përdorimin e kompjuterit


Asnjëri prej të anketuarve nuk ka kryer kurse për përdorimin e kompjuterit. Përgjigjja e disa nxënësve të deklaruar është se ata kanë mësuar përdorimin e kompjuterit në shtëpi pa ndihmën e askujt.

---

### 3.4. Njohuritë e nxënësve për ta përdorur kompjuterin

Pyetjes se sa kanë njohuri nxënësit në përdorimin e kompjuterit, më shumë se dy të tretat po 69.7% e nxënësve i janë përgjigjur se kanë shumë njohuri në përdorimin e tij, kurse 26.5 janë përgjigjur se kanë pak njohuri. Vetëm 3.8% prej tyre, siç tregon edhe grafiku në vazhdim, nuk dinë ta përdorin atë.

Graf. 13



Në përqindjet e paraqitura në grafikun më lart, shohim se ka edhe nxënës, që nuk dinë fare ta përdorin kompjuterin. Në Kornizën e Kurrikulës së Kosovës (2011), nxënësit duhet t'i zhvillojnë kompetencat e TIK-ut për të arritur një sistem të integruar dhe koherent të dijeve, të shkathtësive që u nevojiten për t'u ballafaquar me sfidat e epokës digjitale dhe të ekonomisë së tregut të lirë. Gjatë intervistimit tonë me nxënësit kemi marrë mendime dhe opinione të ndryshme, e sidomos, kërkesa e tyre ishte që të mbajnë kurse të ndryshme për edukimin e tyre për përdorimin e drejtë të kompjuterit dhe të mjeteve të tjera audiovizuale.

---

### 3.5. Koha që shfrytëzojnë nxënësit pranë kompjuterit

Në tabelën në vijim janë evidencuar përgjigjet e nxënësve përkitazi me kohën e përdorimit të internetit gjatë ditës. Siç shihet edhe nga tabela, 44.8% prej tyre kalojnë tri deri në pesë orë para kompjuterit, 34.9% një deri në dy orë, 10.3% e përdorin kompjuterin gjashtë deri në 8 orë, kurse 2.6% nëntë deri në dhjetë orë. Vetëm 2.2% prej tyre rrinë më pak se një orë në ditë para kompjuterit. Përveç kësaj, disa nga nxënësit kanë deklaruar se ata e përdorin vetëm gjatë fundjavës, apo herë pas here pa ndonjë orar të caktuar për arsye se, siç shprehen ata, u duhet më shumë kohë edhe për të mësuar.

Tabela


	Përqindja
Më pak se 1 orë.	2.2
Një deri në dy orë.	34.9
Tri deri në pesë orë.	44.8
Gjashtë deri në 8 orë.	10.3
Nëntë deri dhjetë orë.	2.6
Ndonjë herë e përdori nga një orë për shkak se më nevojitet më shumë kohë për shkollë.	3.0
Vetëm gjatë fundjavës.	1.7
Varet. Nganjëherë nuk e përdori fare, e nganjëherë e përdori tërë ditën.	0.4

Nga këto rezultate që i kemi paraqitur në këtë tabelë, ne edhe më shumë po bindemi për opinionet e nxënësve, të cilët kërkojnë ndihmë nga mësimitdhënësit, prindërit dhe e gjithë shoqëria, për t'u ndihmuar që të largohen disi nga përdorimi i kompjuterit për lojëra të ndryshme, për shkak se ata nuk po mundën të jenë të vendosur për të mos luajtur më. Njëri prej tyre është shprehur kështu, nxënës i klasës së nëntë: „*Unë natë e ditë jam në gjendje të rri pranë kompjuterit duke luajtur lojëra të ndryshme. Unë kam dëshirë të mos luaj, por nuk po mundem të hezitohj. Krejt mësimin e kam lënë anash, prindërit më bërtasin, por unë mendjen e kam vetëm te lojërat. Lojërat që i luaj janë lojëra me armë dhe lojëra të ndryshme*”. Ky rezultat tregon se nxënësit e kanë humbur interesimin për mësim dhe kanë filluar të largojnë vëmendjen e tyre nga shkolla duke u interesuar më shumë për shfrytëzimin e kohës në internet.

### 3.6. Për çka e përdorin nxënësit kompjuterin

Për të marrë informacione sa më të sakta për atë se për çka e përdorin nxënësit kompjuterin, nga përgjigjet e nxënësve rezulton se 71.8% e përdorin për qëllime mësimore, 67.5% për biseda dhe komunikim me shokë, kurse 40.6% për lojëra.

Graf. 14



---

Nga rezultatet e mësipërme ne shohim se TIK- zë një vend të rëndësishëm në procesin e mësimdhënies dhe të nxënies. Duke u bazuar në të dhënat, shohim se një numër i madh i nxënësve kompjuterin e përdorin për të luajtur lojëra të ndryshme digjitale. Sa u përket fëmijëve në moshë të vogël, ata mund ta përpunojnë vetëm një pjesë të sasisë të informacioneve. Psikologët (Basow, Abrami, 1997) tregojnë se ata fëmijë që luajnë më tepër me lojëra kanë prirje më të madhe se ata që luajnë më pak, që të ekzagjerojnë me sasinë e dhunës në botën që i rrethon. Përveç kësaj, kjo zbuloi se ata fëmijë që luanin më shumë lojëra, kishin prirje më të madhe se ata që luanin më pak, për të pranuar frikën “se një person i keq mund t’u futej në shtëpi”, ose “kur të dilnin jashtë dikush mund t’i dëmtonte”. Ata që shohin shumë filmat dhe emisionet e tjera ku shfaqet dhunë kriminale e shohin qytetin e tyre si një vend të rrezikshëm. Ata mendojnë se edhe vetë qyteti i tyre ku jetojnë është një vend i rrezikshëm.

Kompjuteri dhe të gjitha mediat e tjera elektronike për çdo vit zëvendësojnë më shumë orë nga jeta aktive e njerëzve. Lojërat po ndikojnë në sjelljen agresive të fëmijët, si dhe në uljen e motivimit për mësim. Humbja e kohës para kompjuterit dhe moskujdesi i prindërve për mbajtjen nën kontroll të fëmijëve të tyre lidhur me atë se çfarë shohin në televizor, çfarë luajnë në internet dhe me video lojra, si dhe me kë komunikojnë ndikon shpesh në sjellje, në stilin e jetesës dhe në suksesin e tyre në shkollë. „Varësia e të rinjve ndaj internetit, televizorit dhe lojrave të ndryshme është kthyer në shqetësim për prindërit, të cilët nuk dinë si të veprojnë. Këshilla që psikologët japin për prindërit është: norma e dëgjimit në krahasim me të folurit e




prindërve është pesë me një. Flisni një minutë dhe dëgjoni pesë të tjera.

### 3.7. Programet kompjuterike që përdoren nga nxënësit

Programet të cilat nxënësit i përdorin më shumë, qoftë me qëllim mësimi apo edhe për biseda e komunikim dhe lojëra, janë Google me 63.6% dhe Facebook me 54.1%. Programe të tjera të shfletuara nga nxënësit me një përqindje pak më të ulët janë You Tube me 34.2%, Messenger me 23.4% dhe Wikipedia me 14.7%. Twitter dhe Skype përfaqësohen me përqindje më të ulëta: 6.5 %, përkatësisht 5.6 %. Nga programet e Microsoft Office -it ata përdorin Word-in (20.8 %) dhe Excel-in (11.7%). Nxënësit shfletojnë edhe programe të tjera aplikative apo për lojëra, por me një përqindje të vogël, siç janë Paint, Adobe Photoshop, MaviMaker etj.

Graf. 15



---

Nga rezultatet e mësipërme mund të shohim se përqindje më të madhe kanë programet Google dhe Facebook. Mirëpo, kur janë pyetur nxënësit se për çka përdorni Facebook-un, ata janë përgjigjur: „***Ne kalojmë një kohë të gjatë në Facebook dhe nuk mund të largohemi, sepse gjithmonë mendja na rri vetëm aty. Ne mundohemi të largohemi nga ky përdorim jo i drejtë, por nuk mundemi.***”

Facebook-u po të përdoret drejt nga nxënësit do të jetë sinjë ndihmë për ta, sepse ofron ekspozimin ndaj botës së jashtme. Kjo rezulton në një shkëmbim pikëpamjesh nga të rinjtë e komuniteteve të ndryshme, duke pasur një shkëmbim global të informacionit nga e gjithë bota. Efekti social i Facebook-ut realizohet duke u bashkuar gjithnjë e më shumë me faqet e rrjeteve sociale.

Të rinjtë mund të qëndrojnë në kontakt me të tjerët dhe të kenë qasje me shokët e klasës dhe me të afërmit, duke u informuar për çdo rrethanë të jetës së tyre. Distanca më nuk është problem i tyre, vetëm një mesazh privat në Facebook apo vetëm një cingërimë e telefonit, është sikur ata janë aty, edhe pse janë me kilometra larg. Jo të gjithë prej nxënësve ndjehen të përkrahur nga miqtë e tyre, familja dhe shokët. Nxënësit kanë nevojë për një grup mbështetjeje. Problemet e tyre janë të shumta, meqenëse tema të ndryshme, si duhani, droga, alkooli etj, janë probleme që nxënësit i preokupojnë çdo ditë, që përpara kanë qenë tabu për të folur rreth tyre, ndërsa sot të rinjtë mund të gjejnë forume në internet, që i mbështesin për zgjedhjen e problemeve të tyre. Përmes internetit nxënësit rrisin komunikimin dhe krijojnë lidhje të forta me të rinjtë në tërë botën. Të rinjtë mund të njoftohen me grupmosha të tyre


---

nga komunitete të ndryshme, si dhe kanë mundësinë të njihen me kulturën dhe traditën e tyre.

### 3.8. Integrimi i TIK-ut gjatë procesit të mësimdhënies

Nga të gjithë nxënësit e anketuar, 62.8%, përgjigjen se mësimdhënësit nuk përdorin metoda mësimore duke përfshirë edhe përdorimin e kompjuterit, kurse 37.2% prej tyre janë deklaruar pozitivisht.

Graf. 16



### 3.9. Përdorimi i metodave mësimore përmes TIK-ut nga mësimdhënësit

Përgjigjet nga pyetja plotësuese se çfarë metoda përdorin mësimdhënësit duke e përfshirë TIK –un në mësimdhënie janë dhënë në tabelën në vijim të punimit. Numri më i madh i nxënësve apo 32.9% shprehen se mësimdhënësit nuk e integrojnë kompjuterin për mësim për shkak se nuk kanë

---

njohuri ta përdorin, kurse 17.1% shpjegimin e njësive mësimore e bëjnë duke kërkuar nga nxënësit që të sjellin hulumtime nga interneti, e pastaj e zhvillojnë së bashku. Kërkimi në internet për tema të caktuara, prezantimi i mësimëve me video projektor, hartimi i testeve të ndryshme realizohet 15.8 %,demonstrimi i temave të ndryshme, shpjegimi i njësive mësimore në orën e teknologjisë janë po ashtu disa nga mënyrat e mësimdhënies me përdorimin e kompjuterit, të cilat përfaqësohen me nga një përqindje përafërsisht të njëjtë prej 9.2 deri në 15.8 %. Në vijim do të paraqesim përqindjen e të dhënave,

Shpjegimi i njësive mësimore në lëndën e teknologjisë 13.2%

Demonstrimi i temave të ndryshme 11,8%

Prezentimi i temave mësimore me projektor 9,2 %

Nuk dinë ta përdorin 32.9%

Hartimi i testeve të ndryshme 15,8%

Kërkojnë nga ne që të sjellim hulumtime në internet 17,1 %


Gjatë analizës së të dhënave ne kemi vërejtur se pyetjes që u kemi bërë mësimitdhënësve se sa e integrojnë teknologjinë digjitale në procesin e mësimitdhënie, 78.2% të mësimitdhënësve janë përgjigjur se e integrojnë TIK-un, kurse 21.8% prej tyre e kanë mohuar këtë. Nëse bëjmë krahasimin e kësaj përgjigjeje në mes të mësimitdhënësve dhe nxënësve, atëherë mund të kemi dilema të ndryshme, për arsye se përqindja e kësaj përgjigjeje ndryshon shumë, derisa nxënësit përgjigjen se 62.2% se nuk e integrojnë TIK-un, dhe 37.2% e mësimitdhënësve deklarohen se e përdorin.

### 3.10. Përdorimi i mjeteve tjera audio-vizuale

#### ( TV, DVD, projektor...)

Pyetjes, nëse mësimitdhënësit përdorin mjete tjera audio-vizuale (TV, DVD, video projektor etj.), 40.4% të nxënësve i përgjigjen se ata gjatë mësimitdhënies përdorin edhe mjete të tjera audio-vizuale, kurse 59.6% shprehen negativisht. 17.9% nga të gjithë nxënësit e anketuar nuk kanë dhënë fare përgjigje.

Graf. 17



Sipas nxënësve, pjesa dërmuese e mësimeve të tyre përdorin video projektoren me kompjuter të shkollë se në disa raste edhe me laptop personal, i-pad si dhe radion. Në përgjigjet e tyre këta nxënës kanë evidencuar mësimeve që i përdorin më tepër këto mjete audio-vizuale në lëndët përkatëse, siç është mësimeve i gjuhës shqipe, gjuhës angleze, teknologjisë, i historisë etj. Në tabelën në vazhdim kemi paraqitur përqindjen e mësimeve klasorë dhe lëndorë që kanë përdorur TIK-n gjatë mësimeve.

Tabela

Përdorimi i video projektorit nga mësimeve

	Përqindja
Arsimtarët e gjuhës shqipe përdorin në klasë video projektor.	34.3
Arsimtarët e gjeografisë përdorin në klasë video projektor.	12.9
Arsimtarët e historisë përdorin video projektoren.	7.1
Arsimtarët e gjuhës angleze përdorin radion.	21.4
Mësueset e ciklit fillor përdorin video projektoren.	7.1
Arsimtari i teknologjisë përdor në klasë video projektor.	17.1

Në përqindjet e mësimeve lëndorë, po ashtu edhe gjatë bisedës tonë me nxënësit, ata na janë përgjigjur se mësimeve e gjuhës shqipe më së shumti i përdorin mjetet


---

audio-vizuele për mësim, ata kanë cekur se ka mësimdhënës të cilët nuk e përdorin fare .

### 3.11. Përdorimi i TIK-ut sipas udhëzimeve të mësimdhënësve

Pyetjes se a e përdorni TIK-un në shtëpi dhe në shkollë për nevoja mësimore sipas udhëzimeve të mësimdhënësve, 74.7% të nxënësve përgjigjen me jo, kurse 25.3% po. Në grafikun e mëposhtëm janë të paraqitura përgjigjet e nxënësve.

Graf. 18



Nxënësit janë shprehur: „*Ka mësimdhënës të cilët fare nuk na udhëzojnë dhe nuk kërkojnë nga ne asgjë që ka të bëjë me teknologjinë arsimore, përveç kësaj ne nuk kemi kompjuterë në shkollë, po edhe të kishim, ata do të rrinin të pluhurosur në kabinete sikur rrinë në shumë shkolla të tjera pa i përdorur, e kështu do të vepronim edhe ne, nuk do t'i përdornim për nevoja mësimore. Kjo po ndodh për arsye se*


---

*mësimdhënësit, edhe përkundër trajnimeve që kanë mbajtur për përdorimin e TIK-ut, prapëseprapë nuk na stimulojnë për të përdorur, por ka mësimdhënëës që edhe fare nuk dinë ta përdorin.”*

### **3.12. Sa i udhëzojnë mësimdhënësit që përmes integritit të TIK-ut të kryejnë detyrat e shtëpisë**

Nxënësit janë shprehur se 77.4% të mësimdhënëësve nuk kërkojnë detyra shtëpie nga interneti, kurse 21.4% prej tyre pohojnë se kjo ndodh. Nga të gjithë nxënësit e anketuar, tre apo 1.3% përgjigjen se mësimdhënësit kërkojnë nganjëherë detyra.

Graf. 19



Gjatë intervistave me nxënës kemi vërejtur se ata kërkonin ndihmë nga mësimdhënësit, prindërit dhe të gjithë të tjerët që t'i ndihmonin me metoda të ndryshme për t'i larguar nga përdorimi i tepërt i kompjuterit. „*Ne jemi në hall të madh,*



---


*edhe përkundër dëshirës tonë për të mos qëndruar në kompjuter, duke luajtur lojëra të ndryshme, ne prapëseprapë nuk po mund të ndahemi prej tyre. Unë, edhe kur dua të mësoj, nuk mundem, sepse mendja më rri gjithmonë te lojërat dhe Facebook-u.”* thoshte një nxënës i klasës së shtatë.

Shpenzimi i kohës së nxënësve duke keqpërdorur internetin për komunikim dhe lojëra të ndryshme mund të shndërrohet në përdorim efektiv të tij në qoftëse mësimdhënësit i obligojnë nxënësit që të hulumtojnë për nevojat e tyre mësimore të përshtatura në kurrikulën e tyre lëndore. Ndërkaqnjë numër tjetër i fëmijëve janë njohës dhe përdorues të drejtë të teknologjisë. Prandaj, meqë ky grup i fëmijëve kalon një kohë të gjatë duke u qasur informatave në këtë mënyrë, metoda tradicionale e punës me ta në sistemin e shkollimit është vërejtur të mos jetë interesante dhe mjaft stimuluese.

### **3.13. Mësimdhënësit lëndorë që integrojnë TIK- në mësim**

Mësimdhënësit që integrojnë TIK-un në mësimdhënie me përqindje më të lartë janë mësimdhënësit e gjuhës angleze (40.6%) dhe të teknologjisë (38.9%). Në një shkallë përafërsisht të njëjtë, sipas nxënësve, kërkohen detyrat nga mësimdhënësit e historisë (29.4%), biologjisë (26.7%), gjeografisë (25.6%), dhe gjuhës shqipe (22.8%). Edhe mësimdhënësit e fizikës, kimisë dhe të muzikës kërkojnë detyra pothuajse me nga një përqindje të barabartë 6-8%, siç tregon edhe grafiku në vazhdim.

Graf. 20




Ekzistojnë dallime të mëdha në lëndët mësimore për organizimin e orës mësimore, duke bërë edhe përfshirjen e teknologjisë në mësim. Në bazë të të dhënave që janë paraqitur në tabelë, mësimdhënësit e gati të gjitha fushave TIK-un janë duke e përdorur si mjet pune. TIK është një prioritet i mësimdhënies, për arsye se pjesa më e madhe e këndvështrimit tonë krijohet nga interneti dhe mesazhet që ai transmeton. Prania e gjithanshme e teknologjive informative të komunikimit dhe mediatizmi i shoqërisë ndikojnë para së gjithash në formimin e identitetit të të rinjve. Të rinjtë, duke qenë të vetëdijshëm për këtë rol të teknologjive mësimore, nevojiten të kenë disa aftësi të caktuara apo kompetenca mediatike. Sipas Kornizës së Kurrikulës së Kosovës, kompetencat përfshijnë një sistem të integruar dhe koherent të shkathtësive, shprehive, njohurive (dijeve) dhe qëndrimeve të nxënësve, si arritje e të nxënësve, për të cilën kontribuojnë të gjitha fushat ndërkurrikulare.

### 3.14. Ndikimi i kompjuterit në arsimimin e nxënësve

Në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur përgjigjet e nxënësve në përqindje, për atë se sa ndikon kompjuteri në arsimimin e nxënësve. 72.6% e nxënësve kanë deklaruar se kompjuteri ndikon në arsimimin tonë, ndërsa 26.5% deklaruan se kompjuteri nuk ndikon në arsimimin tonë, kurse 0.9 janë shprehur se nuk e dinë.

Graf. 21



Në pyetjen plotësuese se nëse kompjuteri ndikon në arsimimin e tyre, si manifestohet ai ndikim, nxënësit kanë dhënë përgjigje të ndryshme të cilat janë evidentuar në tabelën në vijim. Ndikimi me përqindjen më të lartë është në të mësuarit e gjërave që ata nuk i dinë përmes informacioneve që ata i marrin nga interneti, për të cilat deklarohen se nuk i marrin nga mësimdhënësit e tyre, por nga burime të ndryshme interneti, siç është Wikipedia apo të ngjashme, të cilat janë shumë të pasura me materiale nga të gjitha fushat, si histori, biologji, gjuhë,

---

teknologji, si dhe nga arti dhe kultura e popujve të ndryshëm. Përveç ndikimit pozitiv që ka kompjuteri, ai mund të ketë edhe ndikim negativ. *“Nëse e shfrytëzojmë për hulumtime për lëndë të ndryshme, do të ketë ndikim pozitiv, por nëse nuk dimë ta përdorim drejt, ndikimi do të jetë negativ”*, shprehen disa nxënës. *“Kompjuteri na tërheq për lojëra dhe argëtim, e kështu na pengon në mësim,”* thonë disa të tjerë. Disa, nga nxënësit madje kanë potencuar vetëm ndikimin negativ të tij, duke theksuar se në internet paraqesin materiale të ndryshme, që janë të ndaluara dhe të papërshtatshme për moshën e tyre. Në tabelën në vijim, do të paraqesim rëndësinë e kompjuterit për mësim.

### **3.15. Rëndësia e TIK-ut për mësim**

Për rëndësinë e kompjuterit në arsimimin e nxënësve janë dhënë përgjigje të ndryshme. Sipas tyre, rëndësia më e madhe e tij është se aty gjenden informacione të shumta dhe të llojllojshme, nga ku mund të mësohet për gjëra të ndryshme, qoftë për ato që mësohen në shkollë, qoftë për tema të lira nga të gjitha fushat. Në tabelën vijuese janë paraqitur përgjigjet e dhëna nga nxënësit për rolin e TIK-ut në arsimim, por edhe për ndikimin negativ të tij kur ai shfrytëzohet vetëm për lojëra dhe shfletimin e materialeve të papërshtatshme për moshën e tyre.

Tabela

	Përqindja
Mësojmë më shumë për gjërat që nuk i dimë.	17.7
Për gjetjen e informacioneve të ndryshme.	19.5
Për hulumtime të ndryshme.	9.8
Në internet gjejmë informacione të cilat arsimtarët nuk na i tregojnë.	9.1
Kërkimi për tema të caktuara për të cilat nuk kam njohuri.	3.0
Aty ka gjëra që në libra nuk përfshihen, si p.sh. Wikipedia, e cila është e pasur me materiale nga të gjitha fushat si histori, biologji, gjuhë shqipe etj.	4.9
Aty mund të gjejmë të dhëna të bollshme mbi çdo gjë që na nevojitet.	3.0
Për të hulumtuar për vende dhe kultura të huaja.	3.7
Të edukohemi për përdorimin e teknologjisë informative.	2.4
Temën që e kemi mësuar në shkollë e hulumtojmë në kompjuter.	2.4
Përmes kompjuterit mësoj shumë gjëra të reja. Kështu kam mësuar gjuhën angleze.	3.0
Përkthime nga anglishtja.	1.2

Aty lexojmë dhe gjejmë lekturat e nevojshme.	6
Përmes kompjuterit mësoj për astronominë.	1.8
Ndikon mirë, por mund të ketë edhe ndikim negativ.	6.1
Nëse e shfrytëzojmë për hulumtime për lëndë të ndryshme, do të ketë ndikim pozitiv, por nëse nuk dimë ta përdorim drejt, ndikimi do të jetë negativ.	3.7
Kompjuteri na tërheq për lojëra dhe argëtim e kështu na pengon në mësim.	6.7
Ndikon negativisht. Në internet paraqesin materiale të ndryshme që janë të ndaluara dhe të pa përshtatshme për moshën tonë.	1.2

Nga rezultatet e lartpërmendura, shohim se një ndër mjetet më të përdorura të komunikimit interaktiv është interneti. 1.2% të nxënësve deklarohen se në internet paraqesin materiale të ndryshme, që janë të ndaluara dhe të papërshtatshme për moshën e tyre. Me qindra-mijëra adresa, shumica të pakontrolluara, hedhin materiale nga më të ndryshmet, në të cilat ka raste kur ekspozohet edhe dhunë për shkak të lojërave vetë ndryshme. Adresa të ngjashme kanë tërhequr një numër të madh të rinjve, që shikojnë në këto faqe dhe kjo mund të ketë pasoja të mëdha. Interneti është revolucion elektronik që krahas anëve të veta pozitive, ka edhe anët e veta negative. Kryesisht, interneti nga të rinjtë po përdoret për qëllime argëtuese, që shpesh janë edhe me pasoja të natyrave të ndryshme.

---

Ndërsa 6.7% të nxënësve deklarohen se internetin po e përdorin për lojëra të ndryshme, që po ndikojnë në shpenzimin e kohës për shkaqe argëtuese dhe po krijojnë edhe varshmëri të fëmijët. Videolojërat janë një lloj më i veçantë i mediave. Përdoruesit i kërkojnë që të arrijnë një objektiv të caktuar, duke ndjekur një numër rregullash të caktuara. Këto rregulla shpesh i kërkojnë lojtarit që të vrasë persona, apo të shkatërrojë diçka. E gjithë kjo po shpreh agresivitetin e nxënësve, gjë që po reflektohet edhe në shkollë.

Nxënësve një përqindje prej 2.4% kanë shprehur kërkesën e tyre për nevojën për edukimin për përdorimin e TIK- për mësimdhënie. Edukimi mbi TIK përban dy dimensione: edukimin për t'i marrë dhe për t'i shfrytëzuar mesazhet e masë mediave, shkollimin mbi mediat dhe edukimin për zhvillimin e një qëndrimi kritik ndaj mesazheve të masë mediave. Edukimi për teknologjinë mësimore është nevojë shumë e madhe në shoqërinë moderne. Përmes qarkullimit të shpejtë të informacioneve në gjithë botën, nxënësve duhet të përballen me përparësitë dhe jopërparësitë e qasjes dhe të përdorimit të mesazheve të mediave dhe duhet të trajnohen që mesazhet e tyre t'u qasen në mënyrë më kritike

### **3.16. Opinione të nxënësve**

- Do të ishte mirë të kemi të gjitha pajisjet laboratorike për lëndët shkencore e sidomos për lëndët kimi dhe fizikë. Nga kjo, zhvillimi i arsimit do të ishte shumë më i lehtë.
- Kërkojmë nga mësimdhënësit që të na lejojnë t'i marrim laptopat.

- 
- Kërkoj nga shkolla që të mos i mbajnë mbyllur kompjuterët, por të na lejojnë t'i përdorim sidomos për Facebook.
  - Kompjuteri nuk më largohet nga mendja, edhe kur mësoj mendjen e kam tek ai.
  - Kompjuteri nevojitet për komunikim, për hulumtime në mësim, por në shkollë asnjë arsimtar nuk na udhëzon që kompjuterin ta përdorime dhe për detyrë shtëpie.
  - Arsimtarët ta përdorin teknologjinë informative, sepse kështu zhvillohet më mirë mësimi praktik, për të cilin kemi nevojë.
  - E di se është gabim që rri një kohë të gjatë pranë kompjuterit dhe kam shumë nevojë ta ndryshojë këtë gjë.
  - Të mbajmë trajnime edhe ne për të na mësuar për përdorimin e kompjuterit për mësim.
  - Mësimdhënësit të përqendrohen më shumë te hulumtimet.

### **3.17 Opinionet e mësimdhënësve**

- Kam një porosi për prindërit që fëmijët e tyre të përcillen me vëmendje në atë së për çfarë e përdorin kompjuterin. T'u kufizohet koha dhe të përcjellin se çfarë po shfletojnë ata;
- Shkollat duhet të furnizohen edhe me materiale të tjera të nevojshme. Për shkollën më me rëndësi të madhe është higjiena, e për këtë gjë duhet të mendojë Ministria



---

e Arsimit. Duhet të vijmë t'i vizitojmë shkollat e t'i shohin nxënësit se në çfarë kushtesh punohet.

- Në qoftë se kompjuteri, përkatësisht interneti do të shfrytëzohej në mënyrë të mirëfilltë dhe të drejtë, do të ishte shumë i nevojshëm në zhvillimin e procesit edukativo-arsimor.
- Të gjitha shkollat të pajisen me kompjuterë, sepse do të jetë shumë më lehtë si për ne, po ashtu edhe për nxënësit.
- Shkolla ka nevojë që të ketë kabinetin me kompjuterë dhe të shfrytëzohet për çdo lëndë mësimore.
- Është e nevojshme të bëhet kompletimi i shkollave me pajisje digjitale.
- Është shumë i nevojshëm përdorimi i kompjuterëve nëpër shkolla, për arsye se do të na ndihmonte shumë që të kemi një mësimdhënie sa më cilësore.
- Meqë shkolla nuk ka kompjuterë për nxënësit, atëherë ne nuk e shohim të arsyeshme as të diskutohet për këtë punë.
- Mendoj se është shumë me rëndësi pajisja e shkollës me kompjuterë dhe aftësimi i nxënësve për ta, sepse në këtë mënyrë rritet efikasiteti si në mësimdhënie, ashtu edhe mësimnxënie nga ana e nxënësve.
- Është e nevojshme kompletimi i klasave me kompjuterë.
- Për mësimdhënësit është më mirë të organizohet ndonjë kurs më i thjeshtë (e jo ECDL) që mësimdhënësit të mund ta mësojnë atë më të thjeshtën -Word-in, që të dinë dhetë mund ta përdorin.

---

## Gjetjet kryesore nga hulumtimi

Gjatë analizave të të dhënave, ne kemi identifikuar këtë gjendje momentale në këto shkolla. Në disa shkolla mungon pajisja me kompjuterë, ndërsa disa shkolla kanë kompjuterë mirëpo nuk i përdorin. Në shkolla dominon ende qasja tradicionale e mësimdhënies, edhe përkundër faktit se disa mësimdhënës e përdorin Tik-un në një masë të vogël, duke i kushtuar rëndësi fotografive përmes CD dhe video projektorëve, ndërsa afër 40% të tyre nuk kanë njohuri ta përdorin, edhe përkundër faktit se 68% të mësimdhënësve kanë vijuar trajnime të ndryshme për TIK. Tik-u nga mësimdhënësit përdoret edhe për hartimin e testeve të njohurive. Sipas rezultateve nga ky studim, këto shkolla nuk kanë përfshirje të mjaftueshme të teknologjisë informative të komunikimit në procesin e mësimin. Po ashtu në këto shkolla mungon qëndrueshmëria ndaj inovacioneve në mësimdhënie dhe nxënie. Sipas deklarimeve të nxënësve, ata janë pasivë gjatë procesit mësimor. Planet dhe programet mësimore momentale nuk u kushtojnë rëndësi të madhe shkathtësive të nxënësve, kështu që mësimdhënësit janë të fokusuar në plan dhe program dhe në përmbajtjen e tij, e jo në nxënësit.

Sipas të dhënave, ekziston përdorim i pamjaftueshëm i teknikave mësimore bashkëkohore, si dhe shfrytëzimi i pamjaftueshëm i teknologjisë informative të komunikimit gjatë procesit të mësimdhënies. Meqenëse ekziston mundësia që përmes TIK-ut të realizohet mësimdhënia më praktike, atëherë është vërejtur se shumë pak vëmendje u kushtohet nxënësve, se si ata gjatë jetës së përditshme e shfrytëzojnë TIK-un. Nxënësit janë të udhëzuar shumë pak që TIK-un ta përdorin edhe për

---

nevoja mësimore, edhe përkundër asaj se shkollat nuk janë të pajisura, prapë se prapë mësimdhënësit shumë pak i udhëzojnë që të hulumtojnë në shtëpi dhe ta përdorin edhe si mjet ndihmës për detyrat e shtëpisë. Sipas të dhënave nga mësimdhënësit, 78,2% kanë pohuar se i udhëzojnë nxënësit që ta përdorin TIK-un për hulumtime dhe qëllime të tjera arsimore, ndërsa sipas nxënësve 62,8% të mësimdhënësve nuk i udhëzojnë nxënësit që TIK-un ta përdorin edhe për qëllime arsimore. Nxënësit kërkojnë udhëzime që njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e tyre t'i zbatojnë në praktikë. Mësimdhënësit që më së shumti e integrojnë Tik-un, sipas rezultateve të paraqitura lart, janë mësimdhënësit e gjuhës angleze. Një numër i madh i nxënësve afro tetë orë në ditë i kalojnë pranë kompjuterit duke e përdorur për lojëra dhe për argëtim, të cilët janë të vetëdijshëm për humbjen e kohës dhe një përqindje e tyre ka kërkuar edhe edukim për përdorim të TIK-ut.

---

## IV. Përfundim

Për t'u përballur me ndryshimet themelore që po sfidojnë komunitetet arsimore sot, veçanërisht me integrimin e TIK-ut, është më se i nevojshëm hartimi i politikave dhe i strategjive me synime arsimore afatgjata dhe arritje të reja arsimore. TIK-u nuk është vetëm një mjet për të prezantuar përmbajtjet ekzistuese përmes mjediseve të reja, por ai është gjithashtu një mjet për paraqitjen e modeleve të reja të të nxënimit. Mirëpo gjatë studimit dhe në bazë të analizës së rezultateve të paraqitura, ne kemi nxjerrë këto përfundime.

Në shkollat tona nuk ekziston mënyra e organizuar e mësimit përmes përdorimit të kompjuterit nga nxënësit dhe mësimsdhënësit, në mënyrë që nxënësve t'u mundësohej qasje më e lehtë për përdorimin e kompjuterit për qëllime arsimore. Sipas rezultateve, jemi informuar se disa shkolla kanë kompjuterë e disa jo, mirëpo nuk është e rëndësishme vetëm prania e kompjuterëve në shkolla, por kërkohet aftësim pedagogjik për përdorimin e tyre si për mësimsdhënësit, ashtu edhe për nxënës. Mësimsdhënësit vetëm janë trajnuar për programin ECDL. Sipas rezultateve, ky program ka rezultuar me sukses te mësimsdhënësit, mirëpo gjatë studimit tonë ne kemi të dhëna nga mësimsdhënësit se ata nuk janë të kënaqur me këtë program. Kanë kërkuar programe që kanë të bëjnë me atraktivitet e jo me ato programe, të cilat sipas opinionëve të mësimsdhënësit ishin shumë të vështira për t'u mësuar. Ekzistojnë dy kategori kryesore të shfrytëzimit të kompjuterëve: mësim "nga" kompjuterët dhe mësim "me" kompjuterët. Për të realizuar këtë, kërkohet orientim dhe udhëzim i mësimsdhënësit për t'i stimuluar nxënësit që TIK-

---

unta përdorin për arsim. Shumë nxënës kanë shkathtësi që ta përdorin kompjuterin, por ekziston një dallim i dukshëm në mes shkathtësive në TIK dhe përdorimit të TIK-t për qëllime pedagogjike. Mungesa e udhëzimeve të mësimdhënësve për integrimin e TIK-ut në mësim ishte mjaft e evidente, këtë e vërejtëm gjatë analizës së studimit. Te nxënësit mungonte informimi më konkret lidhur me mundësinë e shfrytëzimit të kompjuterit edhe për qëllime edukativo-arsimore. Shumica e nxënësve kompjuterin e përdorin për lojëra të ndryshme në internet, që po ndikojnë në shpenzimin e kohës për shkaqe argëtuese dhe po krijojnë edhe varshmëri te fëmijët. Komunikimi në Facebook nëmes të nxënësve ishte shpenzim i madh i kohës për biseda me shoqëri dhe që nuk rezultojnë me kurfarë rezultati mësimor. Po ashtu edhe mos kujdesi i prindërve për mbajtjen nën kontroll të fëmijëve të tyre lidhur me atë se çka shohin në televizor, çka luajnë në internet dhe me video lojrash, si dhe me kë komunikojnë ishte shqetësim i mësimdhënësve, të cilët kërkonin kujdes më të shtuar ndaj fëmijëve të tyre, që kjo po ndikon shpesh në sjellje jo të mira, në mënyrën e jetesës dhe në suksesin e tyre në shkollë.

Gjatë studimit ne kemi vërejtur se mësimdhënësit në shkollë nuk i ofrojnë njohuri nxënësve për përdorimin e TIK-ut për nevoja pedagogjike, për shkak se te mësimdhënësit mungonte përqendrimi për strategjitë e mësimdhënies edhe përmes TIK-ut. Po ashtu mësimdhënësit nuk i udhëzojnë nxënësit që të hulumtojnë në internet për nevoja arsimore, që do të ndikonte në edukimin e drejtë të përdorimit të TIK-ut.

TIK-u te nxënësit kishte krijuar varshmëri dhe ata ishin të vetëdijshëm për këtë. Përveç kësaj, ata e ndjenin nevojën për edukim të tyre për TIK-un. Me një fjalë, ata kërkonin ndihmë

---

për t'i liruar nga varshmëria që kishin ndaj TIK-ut, sidomos ndaj internetit.

## **V. Rekomandime**

Bazuar në rezultatet e hulumtimit, jemi përpjekur të japim rekomandime të specifikuar në funksion të ngritjes së cilësisë së mësimdhënies së integruar nëpërmjet TIK-ut.

### **5.1. Rekomandime për mësimdhënës**

- Mësimdhënësit të zbatojnë strategji të ndryshme të mësimdhënies, duke aplikuar metoda të ndryshme vizuale përmes TIK-ut.
- Mësuesimdhënësit t'u kushtojnë kujdes nxënësve që kanë probleme me sjelljeje jo të mira, që kjo mund të jetë si rezultat i përdorimit jo të drejtë të kompjuterit duke e shfrytëzuar më shumë për lojëra sesa për mësim.
- Mësimdhënësit nevojitet të kombinojnë punën e tyre në klasë duke punuar në grupe dhe duke integruar TIK-un bazuar në të nxënit bashkëpunues, duke zhvilluar veprimtari që zhvillohen në klasë dhe veprimtari individuale në distancë.
- Mësimdhënësittë vlerësojnë efektivitetin e TIK-ut në mësimdhënie dhe nxënie dhe në bazë të kësaj ata mund të rrisin produktivitetin në praktikën profesionale të tyre.

- 
- Mësimdhënësit të planifikojnë planin mësimor të tyre, bazuara në mësimet nëpërmjet teknologjisë mësimore, duke përdorur një varg strategjisht udhëzuese për nxënësit individualisht dhe në grupe të vogla/mëdha.
  - Mësimdhënësit t'i udhëzojnë nxënësit që të sigurojnë informacion për temën që kanë në planin dhe në programin e tyre mësimor, duke përdorur një larmi burimesh, siç janë: librat, gazetatat, revistat, videot mësimore, faqet e internetit etj., duke krahasuar dobishmërinë e mediave të ndryshme dhe duke i ballafaquar me ato që vijnë nga burime të ndryshme.
  - Mësimdhënësit t'i inkurajojnë nxënësit të shkëmbejnë informacione në klasë që kanë marrë nga burime të ndryshme mediatike (brenda apo jashtë klase) dhe pastaj të komunikojnë për identifikimin e këtyre burimeve dhe më pastaj të shpjegojnë se pse i kanë vlerësuar këto burime si të besueshme.
  - Mësimdhënësit t'u japin detyra nxënësve dhe t'u japin mundësi që të zgjedhin se cilat mënyra përmes TIK- ut janë mënyra më efektive për ta për të kërkuar informacionin dhe për të përmbushur detyrën e caktuar.
  - Mësimdhënësit t'i inkurajojnë nxënësit që të shkruajnë detyrat e tyre në një formë sikur të ishte në tekstin mësimor, duke përdorur paragrafët, titujt, nëntitujt, ilustrimet, tabelat, grafikët etj.
  - Mësimdhënësit t'i ndihmojnë nxënësit për përmbajtjen e internetit që keqinterpretin një temë apo paraqet informacion çorientues ose të gabuar rreth një teme.

- 
- Mësimdhënësit të vlerësojnë nxënësit, duke i bërë pyetje nxënësveqë të dallojnë gjëra të veçanta kur shohin video apo audio ilustrime fotografike.
  - Mësimdhënësit të gjejnë mundësi bashkëpunuese për projekte me institucionet e komunitetit,(psh. muzeumet, bibliotekat, galeritë, kalatë, etj.) që i përfshijnë nxënësit në analizën ose krijimin e mesazheve mediatike.
  - Të ndihmojnë nxënësit për të kontribuar së bashkunë rrjete sociale në adresa të përbashkëta të e-mailit për të nxjerrë një produkt të përbashkët.
  - Mësimdhënësit t'i lejojnë nxënësit të arsyetojnë përtej aspekteve dhe çështjeve të kurrikulës dhe të identifikojnë aspekte të ndryshme të mesazheve që i marrin nga interneti.
  - Mësimdhënësit të diskutojnë për tekste apo dokumente që i marrin nxënësit nga interneti dhe të bisedojnë përkitazi me to.
  - Mësimdhënësit të mbledhin të dhëna, të cilat tregojnë progresin e nxënësve, në çdo aspekt të mësimnxënies.
  - Të bashkëpunojnë me grupet e caktuara në rrjetë me anë të programeve të përbashkëta dhe mjeteve produktive për të krijuar rezultate mësimore.
  - Mësimdhënësit në bashkëpunim me nxënësit të vlerësojnë informacionin nëpërmjet hulumtimit dhe krahasimit të të dhënave nga burime të shumta.
  - Mësimdhënësit t'i stimulojnë nxënësit që tapërdorin internetin, postën elektronike, tv-në dhe radion për nevoja mësimore.



- 
- Mësimdhënësit të analizojnë rëndësinë e përdorimit të teknologjisë në jetën e përditshme për individë të të gjitha moshave dhe si ndikon përdorimi i kësaj teknologjie në shoqëri;
  - Mësimdhënësit të përdorin mjetet elektronike të vlerësimit online, si dhe portofoliot online;
  - Mësimdhënësit të vlerësojnë arritjet enxënësve online.

## **5.2. Rekomandime për MASHT-in**

- Të gjithë nxënësit të edukohen në shkolla për edukimin e përdorimit të TIK-ut për qëllime të mësimt.
- Integrimi i TIK-ut në përmbajtje mësimore dhe në kurrikula.
- Nxënësve t'u jepet mundësia për zbatimin e TIK-ut në shkolla për nevoja pedagogjike, si dhe mundësia e përkrahjes së punës së tyre për të hulumtuar burime të ndryshme.
- Programi i TIK-ut në shkolla nuk duhet të jetë vetëm prania e kompjuterëve në klasa, por edhe një rishikim dhe modernizim i kurrikulave për teknologjinë informative të komunikimit.
- Në shkollat e arsimit të obliguar të ekzistojë një lëndë e veçantë mësimore për edukimin e nxënësve për përdorimin e TIK-ut për qëllime pedagogjike, sepse nxënësit duhet të pajisen me aftësi dhe dije ideale për të qenë në dobi të vendit.

- 
- Krijimi i disa qendrave të ekspertizës arsimore, që mbështesin projekte me nisma për ndryshimin në nivel shkollë. Ato do të ndikojnë në rishikimin e planeve mësimoreekzistuese dhe materialeve të reja të të nxënit jetësor, veprimtarive dhe platformave bazuar në TIK.
  - Krijimi i agjensive dhe i qendrave për zhvillimin e kompetencave të mësimdhënësve për TIK-un.
  - Trajnim i mësimdhënësve për përdorimin e TIK- ut për nevoja pedagogjike.
  - Formimi i ekipeve ndihmëse për mbështetje në zhvillimet arsimore dhe teknologjike. Shërbime të tillat të përfshijnë trajnime dhe këshilla për mësuesit, trajnerët, drejtorët dhe të gjithë aktorët e sistemit arsimor.
  - Përf forcimin e kompetencave të mësuesve për TIK-un.
  - Përf forcimine kompetencave të nxënësve për TIK-un.
  - Vendosjen e objektivave që lëvizin në të njëjtën kohë me teknologjinë informative të komunikimit.

### **5.3. Rekomandime për nxënës**

Mjetet e TIK-ut dhe praktika e tyre vendosin kompetenca të reja mbi nxënësit.

- Nxënësit të vetëdijësohen për të përdorur TIK-un – nga një këndvështrim funksional, nëse shprehitë bazë (të

---

lexuarit, të shkruarit, të vizatuarit) dhe shprehi të tjera më të larta janë ende pa u zotëruar.

- Nxënësit të bisedojnë në klasë në mënyrë kritike mbi rolin e internetit në jetën e tyre.
- Nxënësit të komunikojnë dhe të diskutojnë përmes e-mailit dhe forumeve të ndryshme për çështje të mësimimit.
- Nxënësit të kërkojnë edukim për teknologji të informacionit dhe komunikimit.
- Nxënësit të gjykojnë përkitazi me këndvështrimet apo mendimet e përdorura në internet.
- Nxënësit të bëjnë pyetje për atë që lexojnë apo shikojnë në internet dhe asaj që është e shkruar në tekste shkollore, sepse kjo ndihmon për të nxjerrë paralelen nëmes të të lexuarit në internet dhe në tekste shkollore.
- Nxënësit të kërkojnë informacione për të gjetur sa më shumë shembuj nga njësia përkatëse, por edhe jashtë temës mësimore, që ka të bëjë me aspektin edukativ.
- Nxënësit të rrisin komunikimin e tyre me mësimdhënës përmes e-mailit;
- Nxënësit ta përdorin rrjetin social për socializim dhe për nevoja të tjera mësimore.
- Nxënësit të jenë të vetëdijshëm se tekstet nga interneti dhe mediat e tjera përcjellin mesazhe dhe vlera dhe ata të jenë në gjendje të interpretojnë dhe të japin konkluzione.

- 
- Nxënësit të bisedojnë për burimet që i kanë marrë nga interneti dhe pastaj të bisedojnë se pse i kanë vlerësuar ato burime.
  - Nxënësit duhet të jenë pjesëmarrës në projekte shkollore dhe të kenë mundësi të përdorin shprehitë kompjuterike.
  - Nxënësit të përdorin forume të medias, p.sh. në rrjete sociale, si p.sh. Facebook apo grupet në adresat e përbashkëta të e-mailit për të kontribuar së bashku në rezultate të mësimi.

#### **5.4. Rekomandime për prindër**

Të përcjellin fëmijët e tyre për mënyrën dhe kohën e përdorimit të TIK-ut në shtëpi.

Të bisedojnë me fëmijët e tyre për pasojat që mund t'i sjellë përdorimi jo i drejtë i TIK-ut në mënyrë që fëmijët të jenë të informuar .

Të bashkëpunojnë me shkolla duke u interesuar për edukatën e fëmijëve në shkollë.

Prindërit së bashku me mësuesin të komunikojnë përmes e-mailit dhe të kujdesen për suksesin e fëmijëve dhe sjelljet e tyre në shkollë.

---

## Literatura

August Vitak “Osnovni problemivo rabotata na grupi, Beograd, 1964

Brown, J. D. Computers in language testing: Present research and some future. 1997

Daniloviç, M. Tehnologija učenja i nastave, Institut za Pedagoška istraživanja, Novi Sad, 1998

Joy Egbert and Elizabeth Hanson-Smith. CALL Environments: Research, Practice, and Critical Issues.1999

Kostiç, B. Osnove teorije komunikacije i informacije, Beograd, 1986

Lawrence. Johnston, L. Carpenter, L. Assistive technology access for all students . New Jersey. 2007

Musai, Bardhyl, Godole Tidita, Abdurrahmani Jonila. Edukimi Mediatik. Tiranë. 2011

Muzhiq, V. Kompjuteri u savremenoj nastavi, Skolska knjiga. Zagreb,1973

Osmani, F. Teknikat dhe teknologjitë mësimore. Tetovë. 2008

Projekt E–Shkollo. Doracak për përdorim inovativ të teknologjisë në shkollat fillore. Shkup. 2006

---

Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar në Kosovë,  
2007-2017

Sivakova, D. Ndikimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në përmirësimin e mësim, Bitola, 2007

Varosanec, Sanja. Zbatimi i kompjuterit në mësim. Zagreb,  
2007

***Burime nga interneti***

[http://europa.eu.int/comm/education/pol/policy/\\_en.html#programe](http://europa.eu.int/comm/education/pol/policy/_en.html#programe)

[http://europa.eu.int/comm/education/pol/policy/\\_en.html#programe](http://europa.eu.int/comm/education/pol/policy/_en.html#programe)

<http://www.meiks.net/repository/docs/>

<http://affnet.ucp.org/uploads/Inclusive%20Education.pdf>

---

## Falënderime

Falënderojmë të gjithë pjesëmarrësit në këtë hulumim, të cilët na mundësuan realizimin e tij. Në mënyrë të veçantë falënderojmë drejtorët e shkollave, të cilët pa ngurruar na mundësuan caktimin e orareve për realizimin me sukses të hulumtimit. Po ashtu falënderoj mëmësimdhënësit dhe nxënësit, pa kontributin e të cilëve studimi nuk do të realizohej.

---

## **Botues**

Instituti Pedagogjik i Kosovës

### **Shtypi**

Shtypshkronja "Teknika", Prishtinë

Tirazhi:500 copë

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

37:004(048)

Mexhuani, Arbnesha

Integrimi i teknologjisë informative të komunikimit në mësimdhënie dhe nxënie / Arbnesha Mexhuani. - Prishtinë: Instituti Pedagogjik i Kosovës, 2014. - 86 f.: ilustr. me ngjyra; 22 cm.

Literatura: f. 83

**ISBN 978-9951-591-10-2**